



AXHENDA e GRAVE RURALE

Agenda delle Donne Rurali

Bashkia - Comune
Kurbin



Gruaja tek Gruaja



Sostegno all'uguaglianza di genere, ai diritti e all'empowerment economico delle donne rurali nel nord dell'Albania

Bashkia - Comune
Kurbin

AXHENDA e GRAVE RURALE

Agenda delle Donne Rurali



Gruaja tek Gruaja





Subjekti zbatues - Ente realizzatore: *CIES Onlus e Gruaja tek Gruaja*

Eksperte për çështjet gjinore - Esperta per le questioni di genere: *Atila Uligaj, Gruaja tek Gruaja*

Ky botim është realizuar me kontributin e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e OJF-ve partnere të projektit dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë.

Ndalohet riprodhimi ose transmetimi i çfarëdo pjese të këtij botimi, me çdo mjet ose në çdo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të zoteruesit të të drejtave të autorit.

Questa pubblicazione è stata realizzata con il contributo della Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo. I contenuti di questa pubblicazione sono di esclusiva responsabilità delle ong partner e non rappresentano necessariamente il punto di vista dell'Agenzia

È vietata la riproduzione o la trasmissione di qualsiasi parte di questa pubblicazione, con qualsiasi mezzo o in qualsiasi forma, senza preventiva autorizzazione scritta da parte del titolare dei diritti d'autore

Fotografitë - Fotografie di Albana Gaci: *Gra te Grupit Burimor Kurbin / Donne del Gruppo Risorsa di Kurbin*

Grafika e Design - Grafica e Design: Antonello Massenti

www.aics.gov.it

www.cies.it

www.cospe.org

www.gtg.al

www.hapatelehte.org

01

HYRJA - INTRODUZIONE

Konteksti	01
Contesto	
Metodologija	02
Metodologia	

02

TEMATIKAT - TEMATICHE

1 - Mirëqenia Sociale	03
Cura Sociale	
2 - Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave	09
Violenza contro Donne e Ragazze	
3 - Ekonomik	13
Empowerment economico	

PËRMBAJTJA INDICE

03

THELLIME - APPROFONDIMENTI

1 - Problemet dhe zgjidhjet e propozuara	19
Problemi e soluzioni proposte	
2 - Qasja Gjinore	33
Approccio di Genere	
3 - Aktorët Kryesorë dhe Roli i tyre	37
Gli Attori Principali e il loro Ruolo	

VEPRIM PILOT - AZIONE PILOTA

Krijimi i një biblioteke publike në Milot	44
Creazione di una biblioteca pubblica a Milot	

HARTA E BASHKISË KURBIN

CARTA DELLA MUNICIPALITÀ DI KURBIN



Sipas të dhënave më të fundit të regjistrimit të vitit 2023, Bashkia Kurbin shtrihet në një sipërfaqe prej **276,25 km²** dhe ka një popullsi totale prej **34.405 banorësh**.

Shpërndarja sipas gjinisë

Meshkuj: 17.256 (50,1%)

Femra: 17.149 (49,9%)

Secondo i dati più recenti del censimento del 2023, la Bashkia di Kurbin si estende su un'area di **276,25 km²** e ha una popolazione totale di **34.405 abitanti**.

Distribuzione di genere

Uomini: 17.256 (50,1%)

Donne: 17.149 (49,9%)

Konteksti

Bashkia Kurbin, pjesë e qarkut Lezhë me qendër në Laç, ka rëndësi strategjike si nga aspekti demografik ashtu edhe socio-ekonomik. Sipas Censusit të INSTAT 2023, popullsia është 34.405 banorë, rreth 26% më pak se në vitin 2011, për shkak të shtesës natyrore negative dhe migrimin të brendshëm e të jashtëm.

Territori përfshin katër njësi administrative, Laç, Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe, ku Laçi përqendron rreth një të tretën e **popullsisë**. Pjesa tjetër është **kryesisht rurale**, me kufizime në aksesin në shërbime, punësim dhe pjesëmarrje sociale të grave.

Kurbin ka pasur një **histori të rëndësishme industriale**, veçanërisht në Laç, por pas mbylljes së fabrikave të dikurshme ekonomia lokale mbështetet kryesisht në fasoneri, bujqësi, peshkim dhe turizmin ditor në zonën Patok dhe Fushë-Kuqe. Në vitin 2023 u regjistruan 1.146 ndërmarrje aktive dhe një pagë mesatare prej 47.388 lekësh, që tregon produktivitet dhe diversifikim të ulët ekonomik.

Sipas analizave të UN Women Albania (GSVCA) dhe GADC, **gratë në Kurbin** përballen me akses të kufizuar në kreditim, teknologji, trajnime dhe rrjete ekonomike, si dhe me mangësi në funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për rastet e **dhunës me bazë gjinore**.

Në të njëjtin raport, u theksua se 33 gra përfituan ndihmë ekonomike në vitin 2020, por asnjë nuk mori “bonus qeraje”, duke dëshmuar për **boshllëqe në politikat e mbështetjes së viktimave**. Faktorët përforcues të dhunës, të evidentuar nga Together for Life, përfshijnë situatën e vështirë ekonomike, mentalitetet patriarkale, nivelin e ulët arsimor dhe abuzimin me alkoolin, elementë të cilët ndërthuren dhe e bëjnë dhunën me bazë gjinore një fenomen të nën-raportuar por të thellë.

Dokumentet e AKPT tregojnë **potenciale të pashfrytëzuara** për zhvillim urban, **turistik dhe ekonomik**, por edhe mungesë investimesh dhe infrastrukturë të amortizuar. Përfaqësimi i ulët i grave në qeverisjen vendore, dhuna gjinore, kufizimi i pjesëmarrjes ekonomike dhe mungesa e trajnimeve profesionale e bëjnë të domosdoshme hartimin e një Agjende Gjinore për Bashkinë Kurbin, të bazuar në evidenca dhe orientuar drejt përfshirjes sociale, sigurisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Contesto

I **Comune di Kurbin**, parte della prefettura di Lezhë e con capoluogo Laç, riveste un'importanza strategica sia dal punto di vista demografico che socio-economico. Secondo il Censimento INSTAT 2023, la popolazione è di 34.405 abitanti, circa il 26% in meno rispetto al 2011, a causa del saldo naturale negativo e della migrazione interna ed esterna.

Il territorio comprende quattro unità amministrative, Laç, Mamurras, Milot e Fushë-Kuqe, con Laç che concentra circa un terzo della **popolazione**. Il resto del territorio è **prevalentemente rurale**, con limitato accesso ai servizi, all'occupazione e alla partecipazione sociale delle donne.

Kurbin vanta una **significativa storia industriale**, in particolare a Laç, ma dopo la chiusura delle fabbriche del passato, l'economia locale si basa oggi principalmente su fasonerie, agricoltura, pesca e turismo giornaliero nell'area di Patok–Fushë-Kuqe. Nel 2023 sono state registrate 1.146 imprese attive e una retribuzione media di 47.388 lek, dati che riflettono un basso livello di produttività e una scarsa diversificazione economica.

Secondo le analisi di UN Women Albania (GSVCA) e GADC, **le donne di Kurbin** affrontano un accesso limitato al credito, alla tecnologia, alla formazione e alle reti economiche, oltre a carenze nel funzionamento del Meccanismo di Riferimento Coordinato per i casi di **violenza di genere**.

Nello stesso rapporto si evidenzia che 33 donne hanno beneficiato di assistenza economica nel 2020, ma nessuna ha ricevuto il “bonus affitto”, segnalando **lacune nelle politiche di sostegno alle vittime**. I fattori che aggravano la violenza, identificati da Together for Life, includono la difficile situazione economica, i modelli patriarcali, il basso livello di istruzione e l'abuso di alcol, elementi che si intrecciano rendendo la violenza di genere un fenomeno profondo e sottostimato.

L'AKPT individua **potenzialità non sfruttate** per lo sviluppo urbano, **turistico ed economico**, ma anche carenza di investimenti e infrastrutture deteriorate. La scarsa rappresentanza femminile nella governance locale, la violenza di genere, la limitata partecipazione economica e la mancanza di formazione professionale rendono necessaria l'elaborazione di un'Agenda di Genere per il Comune di Kurbin, basata su evidenze e orientata all'inclusione sociale, alla sicurezza e allo sviluppo sostenibile.

Metodologjia

Agjendat e Grave Rurale janë realizuar në kuadër të projektit “**Mbështetje për barazinë gjinore, të drejtat dhe fuqizimin ekonomik të grave rurale në veri të Shqipërisë**” AID 12819, i financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe i zbatuar nga CIES Onlus në partneritet me COSPE, Gruaja tek Gruaja dhe Hapa të Lehtë.

Hartimi i Agjendës për Bashkinë Kurbin është zhvilluar **drejtpërdrejt nga 27 gratë**, të moshave dhe shtresave të ndryshme shoqërore, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve të marginalizuara (nënat e vetme, gratë e moshuara dhe të rinjtë e zonave të thella rurale), me lehtësimin e stafit të organizatës **Gruaja tek Gruaja** dhe mbështetjen e QSNNN (Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë).

Gratë u përfshinë në një **proces pjesëmarrës të ndarjes dhe bashkëpunimit**, që kombinon të dhënat ekzistuese me zërin e grave dhe vajzave të komunitetit. Procesi u bazua në parimet e barazisë gjinore, përfaqësimit të barabartë dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në vendimmarrje, duke garantuar për gratë pjesëmarrëse **një hapësirë të mbrojtur për shprehje të lirë dhe demokratike**.

Qasja metodologjike përfshin **4 faza të veçanta**:

1. **Analiza e kontekstit**: shqyrtimi i dokumenteve bashkiake, statistikave dhe raporteve institucionale për të kuptuar sfidat strukturore.
2. **Konsultimet komunitare**: takime me gra dhe vajza nga të gjitha njësitë administrative për të identifikuar problemet më të rëndësishme në fushat e shërbimeve sociale, shëndetësisë, punësimit, arsimit dhe infrastrukturës.
3. **Analiza dhe formulimi i rekomandimeve**: përkthimi i rezultateve të procesit të zhvilluar me gratë në propozime konkrete politike dhe institucionale për bashkinë dhe aktorët vendorë.
4. **Veprimet pilot**: realizimi i një mikroprojekti komunitar të identifikuar nga vetë gratë për t’iu përgjigjur një nevojë të tyre.

Të dhënat u përpunuan sipas qasjes “**problematicë > ndikim gjinor > zgjidhje e propozuar**”, duke ndërtuar për çdo fushë tematike një strukturë që lidh sfidat me pasojat gjinore dhe aktorët përgjegjës. Rezultatet përfundimtare u përmbledhën në **tabela tematike** që shërbejnë si bazë për planifikim, advokim dhe buxhetim me ndjeshmëri gjinore.

Metodologia

Le Agende delle Donne Rurali sono state realizzate nell’ambito del progetto “**Sostegno all’uguaglianza di genere, ai diritti e all’empowerment economico delle donne rurali nel nord dell’Albania**” AID 12819, finanziato dalla Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo e implementato dal CIES Onlus in partnership con COSPE, Gruaja tek Gruaja e Hapa te Lehte.


La **redazione dell’Agenda** per il Comune di Kurbin è stata realizzata **direttamente da 27 donne**, di diverse età ed estrazione sociale, con particolare attenzione ai gruppi marginalizzati (madri single, donne anziane e giovani delle aree rurali più remote) con la facilitazione del personale di **Gruaja tek Gruaja** e il supporto di QSNNN (Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë).

Le donne sono state coinvolte in un **percorso partecipato di condivisione**, che combina i dati esistenti con la voce delle donne e delle ragazze della comunità. Il processo si è basato sui principi di uguaglianza di genere, pari rappresentanza e partecipazione inclusiva ai processi decisionali, garantendo alle donne partecipanti uno **spazio protetto di espressione libera e democratica**.

L’approccio metodologico include infatti **4 fasi distinte**:

1. **Analisi contestuale**: esame dei documenti comunali, delle statistiche e dei rapporti istituzionali per comprendere le sfide strutturali.
2. **Consultazioni comunitarie**: incontri con donne e ragazze provenienti da tutte le unità amministrative per identificare i problemi più rilevanti nei settori dei servizi sociali, della sanità, dell’occupazione, dell’istruzione e delle infrastrutture.
3. **Analisi e formulazione delle raccomandazioni**: traduzione dei risultati del percorso svolto con le donne in proposte politiche e istituzionali concrete rivolte al comune e agli attori locali.
4. **Azioni pilota**: realizzazione di un microprogetto comunitario identificato dalle donne per rispondere ad un loro bisogno.

I dati sono stati elaborati secondo l’approccio “**problematica > impatto di genere > soluzione proposta**”, costruendo per ogni area tematica una struttura che collega le sfide alle conseguenze di genere e agli attori responsabili. I risultati finali sono stati sintetizzati in **tabelle tematiche** che fungono da base per la pianificazione, l’advocacy e la definizione di bilanci sensibili al genere.



TEMATIKA 1

Mirëqenia Sociale

*Bashkia Kurbin përballlet me sfida të mëdha sociale që lidhen me mungesën e hapësirave dhe shërbimeve për të rinjtë, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Mungesa e qendrave rinore dhe aktiviteteve të strukturuar nxit **emigrimin**, ndërsa varfëria, mungesa e transportit dhe e shërbimeve psikosociale thellojnë **izolimin** dhe **cenueshmërinë**. Të moshuarit shpesh jetojnë vetëm dhe pa kujdes, ndërsa **personat me aftësi të kufizuara** përballen me pengesa të mëdha në akses, veçanërisht gratë dhe nënat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilat mbeten ndër grupet më të marginalizuara.*

Tematica 1

Cura Sociale

*La Municipalità di Kurbin affronta **gravi sfide sociali** legate alla mancanza di spazi e servizi per giovani, bambini, anziani e persone con disabilità. L'assenza di centri giovanili e attività strutturate favorisce **l'emigrazione**, mentre la povertà, la carenza di trasporti e di servizi psicosociali accentuano **l'isolamento** e la **vulnerabilità**. Gli **anziani** vivono spesso soli e privi di assistenza, e le **persone con disabilità** incontrano forti barriere di accesso, soprattutto le donne e le madri di figli disabili, che restano tra i gruppi più marginalizzati.*



Mirëqenia Sociale Cura Sociale

1 Të ketë infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve rinore

Të rinjtë në Bashkinë Kurbin përballen me **mungesë të theksuar të hapësirave**, shërbimeve dhe mundësive të dedikuara për zhvillimin e tyre personal, profesional dhe social. Mungesa e infrastrukturës rinore dhe aktiviteteve të mirë-organizuara krijon një **boshllëk të thellë në jetën sociale** dhe komunitare të të rinjve, duke çuar në humbje të motivimit, mbyllje në vetvete dhe ndjenjë të mungesës së perspektivës. Shumë **të rinj ndihen të padëgjuar dhe të papërfaqësuar**, duke perceptuar bashkinë dhe strukturat vendimmarrëse jo të angazhuara në adresimin e nevojave të tyre.

Avere infrastrutture adeguate per realizare aktivita giovanili

I giovani del Comune di Kurbin si trovano ad affrontare una **forte mancanza di spazi**, servizi e opportunità dedicate al loro sviluppo personale, professionale e sociale. L'assenza di infrastrutture giovanili e di attività ben organizzate crea un **profondo vuoto nella vita sociale** e comunitaria dei giovani, portando a perdita di motivazione, chiusura in se stessi e senso di mancanza di prospettiva. Molti **giovani si sentono inascoltati e non rappresentati**, percependo il comune e le strutture decisionali come poco impegnate nel rispondere alle loro esigenze.

Problemët Problemi

Mungesë e hapësirave rinore, aktiviteteve komunitare, programeve kulturore e sportive dhe orientimit profesional; emigrim i lartë i të rinjve; boshllëk social dhe distancë me institucionet.

Mancanza di spazi giovanili, attività comunitarie, programmi culturali e sportivi e orientamento professionale; alta emigrazione dei giovani; vuoto sociale e distanza dalle istituzioni.

Perspektiva Gjimore Prospettiva di Genere

Vajzat e reja përballen me kufizime më të mëdha për shkak të normave tradicionale, pasigurisë në hapësirat publike dhe mungesës së mundësive për aftësi digjitale, profesionale dhe lidhësi. Rrezik për izolim social, martesë të hershme, varësi ekonomike dhe përjashtim nga vendimmarrja.

Le giovani ragazze affrontano maggiori limitazioni a causa delle norme tradizionali, dell'insicurezza negli spazi pubblici e della mancanza di opportunità per sviluppare competenze digitali, professionali e di leadership. Rischio di isolamento sociale, matrimoni precoci, dipendenza economica ed esclusione dalle decisioni.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Krijimi i një Qendre Rinore Multifunkionale në Laç.
- Forcimi i Këshillit Rinor të Bashkisë Kurbin.
- Hapja e klubeve rinore në çdo njësi administrative.
- Grante të vogla për nisma të udhëhequra nga vajzat (art, media, teknologji, komunitet).
- Mentorim dhe praktika 1–3 mujore në kompani.
- Creazione di un Centro Giovanile Multifunzionale a Laç.
- Rafforzamento del Consiglio Giovanile del Comune di Kurbin.
- Apertura di club giovanili in ogni unità amministrativa.
- Piccoli grant per iniziative guidate da ragazze (arte, media, tecnologia, comunità).
- Mentoring e tirocini da 1 a 3 mesi presso aziende locali.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin
- ZVAP / Zyrat Arsimore.
- QFP
- Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.
- OJF rinore dhe organizatat e grave (p.sh. GtG).
- Bizneset lokale (mentorim & praktika).
- Bibliotekat, qendrat komunitare dhe klubet sportive.
- Bashkia Kurbin
- ZVAP / Zyrat Arsimore
- QFP
- Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme
- OJF rinore dhe organizatat e grave (p.sh. GtG)
- Bizneset lokale (mentorim & praktika)
- Bibliotekat, qendrat komunitare dhe klubet sportive

Prioritet 1
Priorità 1



Mirëqenia Sociale Cura Sociale

2 Të kenë hapësira për lojë dhe mbështetje psikosociale për fëmijët.

Në Bashkinë Kurbin, qasja e fëmijëve në hapësira të sigurta dhe zhvillimore është e kufizuar. **Fëmijët shpesh luajnë në vende të pasigurta**, si rrugë, sheshe të pashtuara ose ambiente informale dhe **aktivitetet pas-shkollore** janë të pakta, spontane dhe **jo sistematike**. Situata është më kritike në aspektin e shërbimeve psikosociale. Në shumicën e shkollave **mungon prezenca e rregullt e psikologëve**, ndërsa në komunitet nuk ka struktura që ofrojnë këshillim, terapi ose ndërhyrje të hershme psiko-emocionale.

Problemet Problemi

Mungesë parqesh, kënde lojërash dhe hapësirash të sigurta për fëmijët; qendrash komunitare; aktivitete pas-shkollore si dhe shërbimesh psikosociale, sidomos për fëmijët që përfetojnë dhunë, varfëri ose emigrim të prindërve.

Mancanza di parchi, aree giochi e spazi sicuri per i bambini; centri comunitari; attività extrascolastiche e servizi psicosociali, soprattutto per i bambini che subiscono violenza, povertà o l'emigrazione dei genitori.

Perspektiva Gjinore Prospettiva di Genere

Vajzat përballen me kufizime më të mëdha në hapësirat publike për shkak të paragjyqimeve gjinore dhe detyrave shtëpiake, duke humbur mundësi për lojë dhe zhvillim social. Mungesa e hapësirave të sigurta ul vetëvlerësimin dhe potencialin e tyre akademik e social.

Le bambine affrontano maggiori restrizioni negli spazi pubblici a causa di pregiudizi di genere e incarichi domestici, perdendo opportunità di gioco e sviluppo sociale. La mancanza di spazi sicuri riduce autostima e potenziale accademico e sociale.

Prioritet 2 Priorità 2

Disporre di spazi per il gioco e di supporto psicossociale per i bambini

Nel Comune di Kurbin, l'accesso dei bambini a spazi sicuri e stimolanti è limitato. **I bambini spesso giocano in luoghi pericolosi**, come strade, piazze non pavimentate o ambienti informali, e le **attività extrascolastiche** sono poche, spontanee e **non sistematiche**. La situazione è ancora più critica per rispetto ai servizi psicosociali: nella maggior parte delle scuole **manca la presenza regolare di psicologi**, mentre nella comunità non esistono strutture che offrano consulenza, terapie o interventi psico-emotivi precoci.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Krijimi dhe rehabilitimi i këndeve të lojërave në çdo njësi administrative.
- Hapja e qendrave komunitare pas-shkollore.
- Shërbim i lëvizshëm me psikologë për shkollat dhe komunitetet e largëta.
- Programi "Prindërim pozitiv" për familjet vulnerabël.
- Trajnime për mësuesit dhe kujdestarët.
- Creazione e riqualificazione di aree giochi in ogni unità amministrativa.
- Apertura di centri comunitari doposcuola.
- Servizio mobile con psicologi per scuole e comunità remote.
- Programma "Genitorialità positiva" per le famiglie vulnerabili.
- Formazione per insegnanti e tutori.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Investimeve Publike
- Drejtoria Arsimore dhe shkollat 9-vjeçare/mesme
- Qendrat Shëndetësore
- Psikologët e shkollave dhe shërbimet psikosociale
- OJF për fëmijë dhe organizatat e grave
- Këshillat e prindërve dhe komuniteti lokal
- Comune di Kurbin, Direzione dei Servizi Sociali e Investimenti Pubblici
- Direzione Scolastica e scuole di 9 anni / secondarie
- Centri Sanitari
- Psicologi scolastici e servizi psicosociali
- ONG per bambini e organizzazioni femminili
- Consigli dei genitori e comunità locale



Mirëqenia Sociale Cura Sociale

3 Disponueshmëri e qendrave ditore dhe e kontakteve sociale

Bashkia Kurbin po përballët me **një rritje të dukshme të numrit të të moshuarve që jetojnë vetëm**, si pasojë e disa faktorëve strukturorë: emigrimi i fëmijëve, varfëria, prishja e familjes tradicionale dhe mungesa e rrjeteve mbështetëse në komunitet. Pjesa më vulnerabël janë **të moshuarit që jetojnë në zonat rurale**, ku izolimi gjeografik kombinohet me mungesën e transportit publik, rrugët e amortizuara dhe mungesën e shërbimeve bazë. Situata është e rënduar edhe nga mungesa e shërbimeve të kujdesit në shtëpi.

Problemet Problemi

Mungesa e qendrave ditore për të moshuarit; shërbimesh në banesë; izolim social i thellë; vështirësi në aksesimin e shërbimeve shëndetësore, sidomos në zonat rurale.

Mancanza di centri diurni per gli anziani; servizi domiciliari assenti; profondo isolamento sociale; difficoltà nell'accesso ai servizi sanitari, soprattutto nelle zone rurali.

Perspektiva Gjimore Prospettiva di Genere

Gratë e moshuara janë veçanërisht të pambrojtura: pensionet e ulëta, varësia ekonomike dhe izolimi rrisin rrezikun e varfërisë, sëmundjeve kronike dhe përjashtimit social.

Le donne anziane sono particolarmente vulnerabili: pensioni basse, dipendenza economica e isolamento aumentano il rischio di povertà, malattie croniche e esclusione sociale.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Krijimi i një Qendre Ditore për të Moshuarit në Laç.
- Shërbime ditore të lëvizshme në Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe.
- Shërbime në banesë (home-care) për të moshuarit që jetojnë vetëm.
- Krijimi i një rrjeti vullnetarësh të rinj për aktivitete ndërbreznore (lexime, biseda, shoqërim, ndihmë digjitale).
- Creazione di un Centro Diurno per Anziani a Laç.
- Servizi diurni mobili a Mamurras, Milot e Fushë-Kuqe.
- Servizi domiciliari (home-care) per anziani soli.
- Creazione di una rete di giovani volontari per attività intergenerazionali (letture, conversazioni, compagnia, supporto digitale).

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin, Drejtoria e Kujdesit Social.
- Qendrat Shëndetësore, Drejtoria Rajonale (DRShP).
- (OJF).
- Komunitetet fetare (famulli, xhami).
- Rrjetet e vullnetarëve dhe grupet rinore.
- Farmacitë dhe bizneset lokale (për mbështetje me donacione)
- Bashkia Kurbin, Direzione dei Servizi Sociali.
- Centri Sanitari, Direzione Regionale (DRShP).
- ONG.
- Comunità religiose (famiglie, moschee).
- Reti di volontari e gruppi giovanili.
- Farmacie e imprese locali (per supporto tramite donazioni).

Prioritet 3
Priorità 3



Mirëqenia Sociale Cura Sociale

4 Të luftohet varfëria, papunësia dhe mungesa e transportit

Varfëria e qëndrueshme dhe **mungesa e mundësive** ekonomike përbëjnë një nga sfidat më të mëdha strukturore për Bashkinë Kurbin. Zvogëlimi i vendeve të punës, **mungesa e bizneseve prodhuese**, dominanca e punësimeve me **të ardhura të ulëta** dhe rritja e kostove të jetesës i vendosin shumë familje në një **situatë ekonomike të brishtë**. Kjo situatë është veçanërisht e dukshme në njësitë administrative si Gorre, Fushë-Kuqe, Milot dhe Mamurras.

Problemët Problemi

Varfëri e lartë në disa zona të bashkisë; papunësi e qëndrueshme; mungesë transporti publik në zonat rurale izolim nga shërbimet publike, tregjet dhe qendrat e formimit profesional; mundësi të kufizuara për punësim dhe trajnim.

Alta povertà in alcune zone del comune; disoccupazione persistente; mancanza di trasporto pubblico nelle aree rurali; isolamento dai servizi pubblici, dai mercati e dai centri di formazione professionale; opportunità limitate di occupazione e formazione.

Perspektiva Gjimore Prospettiva di Genere

Gratë përballen me përjashtim: të ardhura të ulëta, ngarkesë në punët e kujdesit dhe lëvizje e kufizuar. Mungesa e transportit i izolon nga puna dhe trajnimi. Vajzat rriten me role tradicionale, ndërsa për gratë e varfra rurale, transporti dhe informacioni i kufizuar pengojnë aksesin në shërbime dhe mundësi.

Le donne affrontano esclusione: reddito basso, carico di cura e mobilità limitata. La mancanza di trasporto le isola da lavoro e formazione. Le ragazze crescono con ruoli tradizionali, mentre per le donne rurali povere trasporto e informazioni limitate bloccano l'accesso a servizi e opportunità.

Contrastare povertà, disoccupazione e la mancanza di trasporti 4

La **povertà persistente** e la **mancanza di opportunità** economiche rappresentano una delle principali sfide strutturali per il Comune di Kurbin. La riduzione dei posti di lavoro, la **scarsità di imprese produttive**, la prevalenza di occupazioni a **basso reddito** e l'aumento del costo della vita pongono molte famiglie in una **situazione economica fragile**. Questa situazione è particolarmente evidente nelle unità amministrative come Gorre, Fushë-Kuqe, Milot e Mamurras.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Transport publik i rregullt nga zonat rurale drejt Laçit dhe qendrave të formimit.
- Qendra "One-Stop" për shërbime sociale, punësim dhe trajnime.
- Punë komunitare e përkohshme për familjet me të ardhura të ulëta.
- Subvencione transporti për gratë dhe vajzat që ndjekin kurse ose punë sezonale.
- Trasporto pubblico regolare dalle aree rurali a Laç e centri formativi.
- Centro "One-Stop" per servizi sociali, lavoro e formazione.
- Lavoro temporaneo comunitario per famiglie a basso reddito.
- Sovvenzioni trasporto per donne e ragazze in corsi o lavori stagionali.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Transportit.
- Zyra e Punës / Agjencia Kombëtare e Punësimit.
- QFP.
- Operatorët privatë të transportit.
- Organizatat e shoqërisë civile.
- Bizneset lokale për praktika pune dhe punësim.
- Comune di Kurbin – Direzione del Benessere Sociale e dei Trasporti.
- Ufficio del Lavoro / Agenzia Nazionale per l'Occupazione.
- QFP.
- Operatori privati di trasporto.
- ONG
- Imprese locali per tirocini e opportunità di lavoro.

Prioritet 4
Priorità 4



Mirëqenia Sociale Cura Sociale

5 Disponueshmëria e shërbimeve mbështetëse dhe përfshirëse për personat me aftësi të kufizuara

Në Kurbin *mungojnë qendrat ditore dhe shërbimet mbështetëse* për personat me aftësi të kufizuara (PAK). Infrastruktura publike dhe institucionet nuk janë të përshtatura për akses fizik, dhe mungon një sistem koordinimi ndërmjet bashkisë, shëndetësisë dhe arsimit për ofrimin e mbështetjes. **Në zonat rurale**, personat me aftësi të kufizuara shpesh varen plotësisht nga kujdesi familjar dhe përjashtohen nga arsimi apo puna.

Disponibilità di strutture e servizi di supporto e inclusione per persone con disabilità

A Kurbin *mancano centri diurni e servizi di supporto* per le persone con disabilità (PAK). L'infrastruttura pubblica e le istituzioni non sono adeguate all'accesso fisico e manca un sistema di coordinamento tra comune, sanità e istruzione per fornire supporto. Nelle **aree rurali**, le persone con disabilità dipendono spesso completamente dalla cura familiare ed sono escluse dall'istruzione e dal lavoro.

Problemët Problemi

Mungesa e qendrave ditore dhe shërbimeve mbështetëse për PAK, infrastrukturë publike jo e aksesueshme, mungesë e koordinimit ndërmjet bashkisë shëndetësisë dhe arsimit, përjashtim nga arsimi, varësi e lartë nga kujdesi familjar.

Mancanza di centri diurni e servizi di supporto per le persone con disabilità, infrastruttura pubblica non accessibile, mancanza di coordinamento tra comune, sanità e istruzione, esclusione dall'istruzione, alta dipendenza dalla cura familiare.

Perspektiva Gjinore Prospettiva di Genere

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim të dyfishtë, rrezik dhune, izolim dhe varfëri. Kujdestaret (nëna/motrat) mbajnë barrën pa mbështetje, ndërsa mungesa e aksesit i bën ato të padukshme në jetën publike dhe në vendimmarrje.

Le donne e ragazze con disabilità subiscono doppia discriminazione, rischio violenza, isolamento e povertà. Le caregiver (madri/sorelle) sopportano il carico senza supporto, mentre la mancanza di accesso le rende invisibili nella vita pubblica e nelle decisioni.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Krijimi i Njesisë PAK për koordinim dhe orientim.
- Qendër ditore ose shërbim i lëvizshëm për terapi.
- Zbatimi i standardeve të aksesueshmërisë.
- Transport i përshtatur për vizita shëndetësore, arsim dhe shërbime.
- Program punësimi për të rinjtë dhe gratë PAK.
- Creazione di una Unità per coordinamento e orientamento.
- Centro diurno o servizio mobile per terapie leggere.
- Applicazione degli standard di accessibilità.
- Trasporto adeguato per visite sanitarie, istruzione e servizi.
- Programma di lavoro per giovani e donne con disabilità.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin Drejtoria e Shërbimeve Sociale
- Qendrat Shëndetësore/DRShP
- ZVAP/institucionet arsimore
- QFP
- OJF që punojnë me PAK
- Bizneset lokale
- Qendra Kombëtare për Aftësinë e Kufizuar
- Bashkia Kurbin – Drejtoria e Shërbimeve Sociale
- Centri Sanitari/DRShP
- ZVAP/Istituzioni scolastiche
- QFP
- ONG che lavorano con persone con disabilità
- Imprese locali
- Centro Nazionale per le Persone con Disabilità

Prioritet 5
Priorità 5



TEMATIKA 2 Tematica 2

Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave

*Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Bashkinë Kurbin mbetet një nga **sfidat më të mëdha sociale**, e përforcuar nga varësia ekonomike, mentaliteti patriarkal dhe mungesa e shërbimeve mbrojtëse dhe emergjente. Shumë gra heshtin nga **frika e hakmarrjes, izolimi** dhe mungesa e informacionit, ndërsa mungesa e transportit dhe e mundësive lokale për punësim dhe trajnime i bën largimin nga marrëdhëniet abuzive shumë të vështirë. Kjo gjendje krijon **një cikël varësie** që përcillet tek vajzat, duke normalizuar varësinë dhe kufizimin e pavarësisë ekonomike dhe sociale.*

Violenza contro Donne e Ragazze

*La violenza contro donne e ragazze nel Comune di Kurbin rimane una delle **sfide sociali più gravi**, aggravata dalla dipendenza economica, dal patriarcato e dalla mancanza di servizi di protezione ed emergenza. Molte donne tacciono per **paura di ritorsioni, isolamento** e mancanza di informazioni, mentre la carenza di trasporti e di opportunità locali di lavoro e formazione rende difficile lasciare relazioni abusive. Questa situazione crea **un ciclo di dipendenza** che si trasmette alle ragazze, normalizzando la dipendenza e limitando l'autonomia economica e sociale.*



Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave Violenza contro Donne e Ragazze

1 Të punohet për kapërcimin e mentalitetit patriarkal që kufizon rolin e grave dhe vajzave

Normat patriarkale mbeten të **rrënjësura thellë** në kulturën shoqërore të Kurbin. Shprehje si “gruaja duhet të durojë” apo “problemet e shtëpisë nuk nxirren jashtë” vazhdojnë të përdoren për të legjitimuar dhunën dhe për të heshtur zërin e grave. Këto vlera tradicionale krijojnë një mjedis ku **dhuna** shihet **si mjet disipline** apo si pjesë e “zakonshme” e jetës familjare, duke e normalizuar dhe duke e fshehur nga institucionet.

Lavorare per il superamento della mentalità patriarcale che limita il ruolo di donne e ragazze

Le **norme patriarcali** restano **profondamente radicate** nella cultura sociale di Kurbin. Espressioni come “la donna deve sopportare” o “i problemi di casa non si portano fuori” continuano a essere usate per legittimare la violenza e per silenziare la voce delle donne. Questi valori tradizionali creano un contesto in cui la **violenza** è percepita **come uno strumento di disciplina** o come una parte “normale” della vita familiare, contribuendo alla sua normalizzazione e alla sua invisibilità agli occhi delle istituzioni.

Problemët Problemi

Normat patriarkale që legjitimojnë dhunën; stigma ndaj grave që denoncojnë; presion komunitar për të heshtur dhe toleruar dhunën; modele të dëmshme për vajzat dhe djemtë; normalizim i dhunës brenda familjes.

Norme patriarcali che legittimano la violenza; stigma verso le donne che denunciano; pressione comunitaria a tacere e tollerare la violenza; modelli dannosi per ragazze e ragazzi; normalizzazione della violenza all'interno della famiglia.

Perspektiva Gjimore Prospettiva di Genere

Gratë dhe vajzat përballen me gjykim, turpërim dhe izolim kur kërkojnë ndihmë. Autoriteti mashkullor vendos kufizime në lirinë dhe autonominë e tyre. Vajzat mësojnë role nënshtruese, ndërsa djemtë socializohen në modele dominimi. Patriarkati riprodhon pabarazi ndër breza dhe normalizon dhunën si pjesë të jetës së përditshme.

Le donne e le ragazze affrontano giudizio, vergogna e isolamento quando chiedono aiuto. L'autorità maschile impone limiti alla loro libertà e autonomia. Le ragazze imparano ruoli di sottomissione, mentre i ragazzi vengono socializzati in modelli di dominio. Il patriarcato riproduce disuguaglianze tra le generazioni e normalizza la violenza come parte della vita quotidiana.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Fushatë ndërgjegjësimi “Kurbin pa Dhunë”.
- Edukim gjinor në shkolla: marrëdhënie të shëndetshme, të drejta dhe raportim i sigurt.
- Program “Burrat Aleatë”.
- Trajnim i stafit të vijës së parë
- Campagna di sensibilizzazione “Kurbin senza violenza”.
- Educazione di genere nelle scuole: relazioni sane, diritti e segnalazione sicura.
- Programma “Uomini Alleati”.
- Formazione del personale di prima linea.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin (Komunikimi Publik; Arsimit).
- ZVAP; shkollat 9vjeçare dhe mesme.
- DRShP; Qendrat shëndetësore.
- Policia e Shtetit.
- OJF të grave; komunitetet fetare; media lokale; klubet sportive.
- Bashkia Kurbin (Comunicazione Pubblica; Istruzione).
- ZVAP; scuole di base e scuole superiori.
- DRShP; centri sanitari.
- Polizia di Stato.
- ONG femminili; comunità religiose; media locali; club sportivi.

Prioritet 1
Priorità 1



Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave Violenza contro Donne e Ragazze

2 Të marrin më shumë mbështetje nga shoqëria dhe institucionet publike

Një sfidë madhore për gratë që përballen me dhunë është **mungesa e mbështetjes efektive institucionale dhe komunitare**. Në shumë raste, gratë që kërkojnë ndihmë përballen me procedura të ngadalta, mungesë koordinimi mes policisë, shëndetësisë, shërbimeve sociale dhe gjykatave, apo me vonesa në lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Në këtë terren të brishtë, **çdo vonesë mund të jetë fatale**.

Ricevere maggiore sostegno da parte della società e delle istituzioni pubbliche 2

Una delle sfide maggiori per le donne che subiscono violenza è la **mancanza di un sostegno istituzionale e comunitario** efficace. In molti casi, le donne che chiedono aiuto si scontrano con procedure lente, mancanza di coordinamento tra polizia, sanità, servizi sociali e tribunali, oppure con ritardi nell'emissione degli ordini di protezione. In questo contesto fragile, **ogni ritardo può essere fatale**.

Problemet Problemi

Koordinim i dobët institucional; vonesa në urdhrat e mbrojtjes; mungesë reagimi emergjent; viktimizim i dytë nga policia, mjekët, shërbimet sociale; mungesë informacioni të qartë për shërbimet.

Scarso coordinamento istituzionale; ritardi negli ordini di protezione; mancata risposta d'emergenza; seconda vittimizzazione da parte di polizia, medici e servizi sociali; mancanza di informazioni chiare sui servizi disponibili.

Perspektiva Gjinore Prospettiva di Genere

Gratë përjetojnë dyfish rrezik: nga dhunuesi dhe nga sistemi që nuk i mbron. Pyetjet akuzuese, mosbesimi dhe vonesat i dekurajojnë të raportojnë. Vajzat rriten duke parë që institucionet nuk i mbrojnë gratë, duke humbur besimin në drejtësi dhe në rolin e shtetit si garant i sigurisë.

Le donne affrontano un doppio rischio: da parte dell'aggressore e del sistema che non le protegge. Domande accusatorie, sfiducia e ritardi scoraggiano la denuncia. Le ragazze crescono osservando che le istituzioni non tutelano le donne, perdendo fiducia nella giustizia e nel ruolo dello Stato come garante della sicurezza.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Rifunksionalizim i plotë i MKR.
- Zyrë "Një-Ndalesë" në Bashki: psikolog, punonjës social, jurist; regjistër elektronik rastesh; referim i menjëhershëm drejt shërbimeve.
- Trajnime ndërinstitutionale.
- Oficer/e kontakti 24/7.
- Rifunzionalizzazione completa del MKR.
- Ufficio "One-Stop" in Comune: psicologo/a, assistente sociale, giurista; registro elettronico dei casi; indirizzamento immediato ai servizi.
- Formazioni interistituzionali.
- Ufficiale di contatto disponibile 24/7.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin (Koordinatori Vendor për Dhunën; Shërbimet Sociale).
- Policia e Shtetit; Gjykatat; Prokuroria.
- DRShP dhe qendrat shëndetësore.
- OJF të specializuara; Ndihma Juridike Falas; linjat kombëtare të ndihmës.
- Comune di Kurbin (Coordinatore Locale per la Violenza; Servizi Sociali).
- Polizia di Stato; Tribunali; Procura.
- DRShP e centri sanitari.
- ONG specializzate; Assistenza Legale Gratuita; linee telefoniche nazionali di supporto.

Prioritet 2
Priorità 2



Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave Violenza contro Donne e Ragazze

3 Bërja funksionale e një qendre për gratë viktime të dhunës (strehim dhe rehabilitim)

Në Bashkinë Kurbin ***mungon një qendër strehimi dhe rehabilitimi*** për gratë dhe vajzat që përballen me dhunë. Ky është një boshllëk kritik, pasi strehimi emergjent është elementi i parë dhe më i domosdoshëm për mbrojtjen e viktimave. Pa një vend të sigurt për t'u strehuar, shumë gra detyrohen të rikthehen te dhunuesi, duke e bërë ***rrethin e dhunës të pashmangshëm***. Mungesa e strehimit ul efektivitetin edhe të urdhrave të mbrojtjes dhe të punës së policisë.

Rendere operativo un centro per donne vittime di violenza (accoglienza e riabilitazione) 3

Nel Comune di Kurbin ***manca un centro di accoglienza e riabilitazione*** per donne e ragazze vittime di violenza. Senza questo servizio fondamentale, l'ospitalità emergenziale viene a mancare, costringendo molte donne a tornare dal proprio aggressore e rendendo il ***ciclo della violenza inevitabile***. Questa carenza riduce anche l'efficacia degli ordini di protezione e dell'azione della polizia.

Problemët Problemi

Mungesë strehimi emergjent dhe afatshkurtër; mungesë qendre ditore; mungesë shërbimesh psiko-sociale, ligjore dhe ekonomike; rrezik rikthimi tek dhunuesi; standartet e mbrojtjes nuk zbatohen pa infrastrukturën bazë.

Mancanza di un Centro di emergenza e a breve termine; assenza di centri diurni; carenza di servizi psicosociali, legali ed economici; rischio di ritorno dall'aggressore; gli standard di protezione non possono essere applicati senza un'infrastruttura di base.

Perspektiva Gjimore Prospettiva di Genere

Gratë dhe vajzat janë grupi më i ekspozuar ndaj dhunës dhe pa strehë nuk kanë mundësi të largohen. Pa mbështetje për fëmijët, kujdes psikosocial dhe ndihmë ekonomike, ato përballen me rrezik për rikthim në dhunë dhe trauma të përsëritura. Vajzat ndërpresin shkollimin dhe humbasin sigurinë emocionale.

Donne e ragazze sono il gruppo più esposto alla violenza e, senza un rifugio, non hanno la possibilità di allontanarsene. Senza supporto per i figli, assistenza psicosociale e aiuto economico, affrontano il rischio di ricadere nella violenza e di subire traumi ripetuti. Le ragazze interrompono gli studi e perdono sicurezza emotiva.


Veprime të propozuara Azioni proposte

- Hapje e një Qendre Ditore + Apartament Strehimi Emergjent (72 orë–3 muaj).
- Linjë 24/7 dhe numër emergjence.
- Paketë riintegrimi: bonus qiraje 6–12 muaj, kuponë për trajnime, kontrata punësimi, mbështetje për fëmijët.
- Lidhje me qendrat e strehimit rajonale/nacionale
- Apertura di un Centro Diurno + Appartamento di Accoglienza Emergjenziale (72 ore–3 mesi).
- Linea 24/7 e numero di emergenza.
- Pacchetto di reintegrazione: bonus affitto 6/12 mesi, voucher per formazione, contratti di lavoro, supporto per i figli.
- Collegamento con centri di accoglienza regionali/nazionali

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin (Shërbimet Sociale; Buxheti).
- OJF të specializuara (menaxhim shërbimi).
- Policia; Qendrat Shëndetësore; DRShP.
- Donatorët; Prefektura; Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale; strehat rajonale.
- Comune di Kurbin (Servizi Sociali; Bilancio)
- ONG specializzate (gestione del servizio)
- Polizia; Centri Sanitari; Direzione Regionale della Salute Pubblica
- Donatori; Prefettura; Direzione Generale dei Servizi Sociali; centri di accoglienza regionali

Prioritet 3
Priorità 3



TEMATIKA 3 Tematica 3

Fuqizimi Ekonomik

Në Kurbin, *mungesa e mundësive të punësimit*, emigrimi dhe arsimit profesional i pakoordinuar me tregun kanë dobësuar pavarësinë ekonomike të grave. **Gratë** përqendrohen në **sektorë me paga të ulëta** dhe **punë informale**, pa sigurime apo mbështetje financiare. Mungesa e praktikave profesionale i lë të rinjtë, sidomos vajzat, pa aftësi reale për tregun. **Varësia ekonomike** i bën gratë më të cenueshme ndaj **dhunës** dhe përjashtimit. Fuqizimi ekonomik përmes arsimit dhe punësimit të qëndrueshëm është thelbësor për barazi dhe zhvillim lokal.

Empowerment economico

A Kurbin, la *manca di opportunità di lavoro*, l'emigrazione e la scarsa connessione tra formazione professionale e mercato del lavoro hanno indebolito l'autonomia economica delle donne. Le **donne** sono concentrate in **settori a basso reddito** e **lavoro informale**, senza tutele né accesso al credito. L'assenza di tirocini pratici lascia i giovani, soprattutto le ragazze, senza competenze reali. La **dipendenza economica** le rende più vulnerabili alla **violenza** e all'esclusione. L'empowerment economico attraverso formazione e lavoro sostenibile è essenziale per la parità e lo sviluppo locale.



Fuqizimi Ekonomik Empowerment economico

1 Përmirësimi i përputhshmërisë midis arsimit dhe kërkesave të tregut të punës

Në Bashkinë Kurbin, **arsimi nuk është i harmonizuar me nevojat reale të tregut të punës**. Shkollat e mesme vazhdojnë të ofrojnë drejtime tradicionale që nuk pasqyrojnë sektorët që po zhvillohen në ekonomi. Nga ana tjetër një barrierë drejt punësimit është **mungesa e praktikave profesionale të strukturuar**, të cilat, edhe kur ekzistojnë, janë të shkurtëra, formale dhe nuk ofrojnë aftësi të përdorshme në punë.

Problemet Problemi

Arsimi profesional nuk reflekton kërkesat e tregut lokal; mungesë profilizimi dhe lidhje shkollë me biznes. Të rinjtë diplomohen pa aftësi praktike.

L'istruzione professionale non riflette le esigenze del mercato locale; manca la specializzazione e il collegamento tra scuola e impresa. I giovani si diplomano senza competenze pratiche.

Perspektiva Gjimore Prospettiva di Genere

Vajzat preken më shumë, sepse orientohen drejt drejtimeve që nuk lidhen me sektorë të paguar mirë dhe nuk kanë akses në profile teknike; kjo krijon pabarazi të qëndrueshme në të ardhura dhe punësim.

Le ragazze sono le più colpite, poiché si orientano verso indirizzi non collegati ai settori meglio retribuiti e non hanno accesso ai profili tecnici; ciò genera disuguaglianze durature in termini di reddito e occupazione.

Migliorare l'allineamento tra istruzione e richieste del mercato del lavoro

Nella Municipalità di Kurbin, **l'istruzione non è allineata ai reali bisogni del mercato del lavoro**. Le scuole superiori continuano a offrire indirizzi tradizionali che non rispecchiano i settori in crescita dell'economia. Inoltre, una barriera all'occupazione è rappresentata dalla **manca di tirocini professionali strutturati**, che, anche quando esistono, sono brevi, formali e non forniscono competenze realmente spendibili nel lavoro.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Hartëzim i aftësive të kërkuara nga bizneset.
- Përditësim i kurrikulave shkollorë.
- Orientim profesional me qasje gjimore në shkolla.
- Fushata "Vajzat në Zanate": modele suksesi, vizita në shkolla, laboratorë demonstrues, bursa/incentiva për vajzat në profile teknike.
- Mappatura delle competenze richieste dalle imprese.
- Aggiornamento dei curricula scolastici.
- Orientamento professionale con approccio di genere nelle scuole.
- Campagna "Ragazze nei Mestieri": modelli di successo, visite scolastiche, laboratori dimostrativi, borse/incentivi per ragazze nei profili tecnici.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia (Arsim/Zhv. Ekonomik);
- ZVAP
- Zyra e Punës
- QFP; Shkollat profesionale
- Dhoma e Biznesit;
- Bizneset
- OJF
- Municipio (Istruzione/Sviluppo Economico)
- ZVAP
- Ufficio del Lavoro
- QFP; Scuole professionali
- Camera di Commercio
- Imprese
- ONG

Prioritet 1
Priorità 1



Fuqizimi Ekonomik Empowerment economico

2 Kapërcimi i pengesave strukturore që ekzistojnë në zonat rurale (transporti, informimi, kujdesi familjar)

Në zonat rurale të Kurbin, gratë dhe vajzat përballen me **barriera të shumfishta**, të cilat i përjashtojnë nga arsimimi profesional, praktikat dhe punësimi. **Informacioni** mbi kurset, vendet e punës dhe programet e mbështetjes **nuk u mbërrin rregullisht vajzave** në fshat. **Ngarkesa e lartë e punëve familjare** dhe e kujdesit për fëmijët bie pothuajse plotësisht mbi gratë dhe vajzat. Për pasojë, **pabarazia gjinore** përforcohet, ndërsa potenciali i grave dhe vajzave mbetet i pashfrytëzuar.

2 Superare gli ostacoli strutturali presenti nelle aree rurali (trasporti, informazione, cura della famiglia)

Nelle aree rurali di Kurbin, donne e ragazze affrontano **molteplici barriere** che le escludono dall'istruzione professionale, dagli stage e dall'occupazione. Le **informazioni** sui corsi, le opportunità di lavoro e i programmi di sostegno **non raggiungono regolarmente le ragazze** nei villaggi. L'**elevato carico di lavori domestici** e di cura dei bambini ricade quasi interamente su donne e ragazze. Di conseguenza, la **disuguaglianza di genere** si rafforza, mentre il potenziale delle donne rimane inutilizzato.

Problemet Problemi

Mungesa e transportit publik, informacionit dhe shërbimeve mbështetëse pengon aksesin në trajnim dhe punësim në zonat rurale.

La mancanza di trasporti pubblici, informazioni e servizi di supporto ostacola l'accesso a formazione e occupazione nelle aree rurali.

Perspektiva Gjinore Prospettiva di Genere

Vajzat kanë lëvizshmëri të kufizuar, ngarkesë të lartë të punëve të kujdesit dhe përjashtim nga informacioni. Kjo prodhon izolim ekonomik dhe varësi.

Le ragazze hanno mobilità limitata, un carico elevato di lavori di cura e mancanza di accesso alle informazioni. Ciò genera isolamento economico e dipendenza.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Linjë transporti publik rural– Laç me orare të përshtatura.
- Kurse profesionale mobile në fshatra (kuzhinë, qepje, TIK, agroturizëm).
- Subvencion transporti + shërbim kujdesi për fëmijët gjatë trajnimeve.
- Rrjet informimi (WhatsApp/Viber + ekrane informacioni).
- Linea di trasporto pubblico rurale per Laç con orari adattati.
- Corsi professionali mobili nei villaggi (cucina, cucito, ICT, agroturismo).
- Sussidi trasporto + servizi di cura dei bambini durante le formazioni.
- Rete informativa (WhatsApp Viber + schermi informativi).

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia(Transport, Arsim, Sociale)
- QFP;
- ZVAP
- Drejtoria e Bujqësisë operatorët e transportit;
- OJF
- Bizneset blerëse
- Comune di Kurbin
- Centro di Formazione Professionale di Scutari
- Ufficio Locale per l'Impiego
- Organizzazione Gruaja tek Gruaja e ONG locali
- Imprese locali per tirocini professionali e assunzioni

Prioritet 2
Priorità 2



Fuqizimi Ekonomik Empowerment economico

3 Rritja e pranisë së qendrave të formimit profesional të paktën në zonat urbane.

Mungesa e qendrave funksionale të formimit profesional në Bashkinë Kurbin përbën një ndër pengesat më të mëdha për zhvillimin e aftësive të punës, punësueshmërinë dhe pavarësinë ekonomike të banorëve. Aktualisht, shumica e kurseve profesionale ofrohen vetëm në qytetet fqinje, Lezhë, Tiranë apo Shkodër, ndërsa territori i **Kurbinit**, veçanërisht zonat rurale, **mbetet pa infrastrukturë trajnuese**, pa pajisje dhe pa instruktorë të specializuar.

Aumentare la presenza di centri di formazione professionale almeno nelle aree urbane

La **mancanza di centri funzionali** di formazione professionale nel Comune di Kurbin rappresenta uno dei principali ostacoli allo sviluppo delle competenze lavorative, all'occupabilità e all'indipendenza economica dei residenti. Attualmente, la maggior parte dei corsi professionali viene offerta solo nelle città vicine, come Lezhë, Tirana o Shkodër, mentre il territorio di **Kurbin**, in particolare le aree rurali, resta **privo di infrastrutture formative**, attrezzature e istruttori specializzati.

Problemet Problemi

Mungesa e qendrave të kurseve profesionale në Kurbin.

Mancanza di corsi professionali di qualità e adeguati alle esigenze del mercato locale; difficoltà economiche a seguirli; mancanza di informazioni e vincoli sociali che tengono le donne fuori dalla formazione professionale.

Perspektiva Gjimore Prospettiva di Genere

Në zonat rurale të Kurbinit, vajzat dhe gratë kanë pak mundësi për të ndjekur kurse profesionale për shkak të transportit të pamjaftueshëm, kostove të larta dhe kufizimeve familjare. Barrët e punëve të kujdesit dhe normat kulturore kufizojnë lëvizshmërinë e tyre, duke i përjashtuar nga profesione të mirëpaguara dhe duke forcuar varësinë ekonomike dhe pabarazitë gjinore.

Nelle aree rurali di Kurbin, ragazze e donne hanno scarse possibilità di seguire corsi professionali a causa di trasporti insufficienti, costi elevati e vincoli familiari. L'onere dei lavori di cura e le norme culturali limitano la loro mobilità, escludendole da professioni ben retribuite e rafforzando dipendenza economica e disuguaglianze di genere.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Qendra dhe laboratorë të formimit profesional në çdo njësi.
- Kurse të lëvizshme në fshatra.
- Transport dhe kujdes për fëmijët për pjesëmarrësit.
- Instruktorë itinerantë dhe ekspertë lokalë.
- Përdorimi i shkollave si hapësira trajnimi.
- Fushata informimi në komunitetet rurale
- Centri e laboratorë të formimit profesional në çdo Unità.
- Corsi mobili nei villaggi.
- Trasporto e assistenza bambini per partecipanti.
- Istruttori itineranti ed esperti locali.
- Uso delle scuole come spazi di formazione.
- Campagne informative nelle comunità rurali.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin
- Qendrat Komunitare
- QFP
- ZVAP dhe shkollat e mesme profesionale
- Drejtoria e Bujqësisë (për kurse agropërpunimi)
- OJF
- Bizneset lokale
- Donatorë për pajisje dhe laboratorë praktikë.
- Comune di Kurbin
- Centri Comunitari
- CFP
- ZVAP e scuole secondarie professionali
- Direzione dell'Agricoltura (per corsi di trasformazione agricola)
- ONG
- Imprese locali
- Donatori per attrezzature e laboratori pratici

Prioritet 3
Priorità 3



Fuqizimi Ekonomik Empowerment economico

4 Përmirësimi i aksesit ndaj informacionit mbi programet e nxitjes së punësimit

Mungesa e informacionit të qartë, të aksesueshëm dhe të shpërndarë gjerësisht mbi programet e nxitjes së punësimit përbën një nga pengesat më serioze për integrimin ekonomik të grave dhe vajzave në Bashkinë Kurbin. **Shpërndarja e informacionit mbetet shumë e kufizuar.** Njoftimet bëhen kryesisht përmes platformave online, rrjeteve sociale ose afisheve të vendosura fizikisht në Zyrën e Punës në Laç. Këto forma komunikimi nuk mbulojnë gjithë territorin e bashkisë dhe nuk adresojnë **nevojat e grave dhe vajzave** që jetojnë në zona **rurale**.

Problemet Problemi

Mungesa e informacionit për programet e nxitjes së punësimit nga AKPA/Zyra e Punës.

Mancanza di informazioni sui programmi di incentivazione all'occupazione dell'AKPA e dell'Ufficio del Lavoro.

Perspektiva Gjimore Prospettiva di Genere

Gratë dhe vajzat, me akses të kufizuar në internet dhe lëvizshmëri të reduktuar, mbeten të përjashtuara nga kurset, praktikant dhe subvencionet, duke riprodhuar varësinë ekonomike dhe pabarazitë ndërmjet grave urbane dhe rurale.

Donne e ragazze, con minore accesso a internet e mobilità ridotta, restano escluse da corsi, tirocini e incentivi per mancanza di informazioni e trasporti, perpetuando dipendenza economica e disuguaglianze tra donne urbane e rurali.

Migliorare l'accesso alle informazioni sui programmi di incentivazione all'occupazione

La **mancanza di informazioni** chiare, accessibili e ampiamente diffuse sui programmi di incentivazione all'occupazione rappresenta uno dei principali ostacoli per l'integrazione economica di donne e ragazze nel Comune di Kurbin. La **diffusione delle informazioni resta molto limitata**: gli avvisi avvengono principalmente tramite piattaforme online, social network o manifesti affissi presso l'Ufficio del Lavoro di Laç. Questi canali non coprono l'intero territorio comunale e non rispondono adeguatamente ai **bisogni delle donne e delle ragazze** che vivono nelle aree **rurali**.

Veprime të propozuara Azioni proposte

- Rrjeti Informimi "Kurbin Punëson" me njoftime për kurse, praktika dhe vende pune.
- Këndet e informacionit në shkollë, qendra komunitare dhe zyra bashkie.
- Fushata informuese në terren.
- Njoftime të personalizuar për vajzat e papuna përmes ZVAP dhe shkollave të mesme.
- Rete Informativa "Kurbin Assorbe" con notizie su corsi, tirocini e posti di lavoro.
- Angoli informativi nelle scuole, centri comunitari e uffici comunali.
- Campagne informative
- Avvisi personalizzati per ragazze disoccupate tramite ZVAP e scuole superiori.

Aktorët përgjegjës Attori responsabili

- Bashkia Kurbin (Komunikimi Publik, Arsimi, Zhv. Ekonomik)
- Zyra Vendore e Punësimit (ZVAP/AKPA)
- Qendrat Komunitare Shkollat e mesme/ profesionale
- OJF-të e grave dhe rinisë
- Media lokale
- Bashkia Kurbin (Comunicazione Pubblica, Istruzione, Sviluppo Economico)
- Ufficio Locale per l'Occupazione (ZVAP/AKPA)
- Centri Comunitari, scuole medie e professionali
- ONG per donne e giovani
- Media local


Prioritet 4
Priorità 4



Source: Computer
No Signal
To display this image click the button

Thellime mbi problemet dhe zgjidhjet e propozuara


Approfondimenti dei problemi e delle soluzioni proposte



**Mirëqenia
Sociale**
Cura
Sociale



**Dhuna ndaj Grave
dhe Vajzave**
Violenza contro
Donne e Ragazze



**Fuqizimi
Ekonomik**
Empowerment
economico



Të rinjtë: mungesa e aktiviteteve dhe infrastrukturës rinore

Të rinjtë në Bashkinë Kurbin përballen me mungesë të theksuar të hapësirave, shërbimeve dhe mundësive të dedikuara për zhvillimin e tyre personal, profesional dhe social. Bashkia ka shumë pak ose aspak qendra rinore, ambiente komunitare funksionale, aktivitete kulturore dhe sportive të strukturuara, apo programe pjesëmarrjeje qytetare që t'i angazhojnë të rinjtë në mënyrë të qëndrueshme. Sigurimi i ambienteve moderne, miqësore dhe të aksesueshme për të rinjtë është jetik, por aktualisht këto mungojnë pothuajse tërësisht në territor.

Mungesa e infrastrukturës rinore dhe aktiviteteve të mirë-organizuara krijon një boshllëk të thellë në jetën sociale dhe komunitare të të rinjve, duke çuar në humbje të motivimit, mbyllje në vetvete dhe ndjenjë të mungesës së perspektivës. Për shumë të rinj, alternativa e vetme për përparim është emigrimi, qoftë drejt qyteteve të mëdha brenda vendit, qoftë jashtë Shqipërisë. Kjo prirje e lartë emigrimi e dobëson më tej komunitetin, ekonominë vendore dhe kapacitetet e ardhshme të zhvillimit të bashkisë.

Një tjetër problem është distanca e madhe psikologjike dhe praktike mes të rinjve dhe institucioneve lokale. Shumë të rinj ndihen të padëgjuar dhe të papërfaqësuar, duke perceptuar bashkinë dhe strukturat vendimmarrëse si të largëta dhe jo të angazhuara në adresimin e nevojave të tyre. Kjo krijon mosbesim, indiferencë dhe mungesë bashkëpunimi.

Qendër Rinore në Laç dhe klube në njësitë administrative

Për të adresuar mungesën e aktiviteteve dhe infrastrukturës për të rinjtë në Bashkinë Kurbin, mund të krijohen qendra rinore multifunkionale, për shembull në Laç, që ofrojnë hapësira të sigurta dhe gjithëpërfshirëse me laboratorë digjitalë (ICT, robotikë, programim bazë), hapësira për art, muzikë dhe teatër, ambiente sportive dhe lojëra sociale, si dhe shërbime këshillimi për karrierën dhe kalendar mujor aktiviteteve kulturore e sociale.

Mund të hapen klube rinore në çdo njësi administrative (Mamurras, Milot, Fushë-Kuqe) me programe mujorë aktiviteteve dhe të ofrohen grante të vogla për iniciativë të vajzave në art, media dhe teknologji.

Mund të organizohen cikle trajnimi “Vajza Lidere” për zhvillimin e aftësive leadership, digjitale/mediatike dhe sigurisë në hapësira publike.

Gjithashtu, të rinjtë mund të përfshihen më aktivisht në jetën publike përmes forcimit të Këshillit Rinor të Bashkisë Kurbin, duke marrë pjesë në fushata kulturore, debate publike, mentorim dhe praktika 1-3 mujore me biznese lokale, me module për aftësi të përgjithshme (“soft skills”).

Gioventù: mancanza di attività e infrastrutture giovanili

I giovani nel Comune di Kurbin si trovano di fronte a una marcata carenza di spazi, servizi e opportunità dedicate al loro sviluppo personale, professionale e sociale. Il comune dispone di pochissimi o nessun centro giovanile, ambienti comunitari funzionali, attività culturali e sportive strutturate, o programmi di partecipazione civica in grado di coinvolgere i giovani in modo continuativo. Garantire spazi moderni, accoglienti e accessibili per i giovani è fondamentale, ma attualmente questi mancano quasi completamente sul territorio.

La mancanza di infrastrutture giovanili e di attività ben organizzate crea un vuoto profondo nella vita sociale e comunitaria dei giovani, portando a perdita di motivazione, chiusura su sé stessi e senso di mancanza di prospettive. Per molti giovani, l'unica alternativa di avanzamento è l'emigrazione, verso grandi città interne o all'estero. Questa elevata tendenza all'emigrazione indebolisce ulteriormente la comunità, l'economia locale e le future capacità di sviluppo del comune.

Un altro problema è la grande distanza, sia psicologica che pratica, tra i giovani e le istituzioni locali. Molti giovani si sentono inascoltati e non rappresentati, percependo il comune e le strutture decisionali come distanti e poco impegnate nell'affrontare le loro esigenze. Ciò genera sfiducia, indifferenza e mancanza di collaborazione.

Centro Giovanile a Lac e Club nelle unità amministrative

Per rispondere alla mancanza di attività e infrastrutture per i giovani nel comune di Kurbin, si potrebbero creare centri giovanili multifunzionali, ad esempio a Laç, che offrirebbero spazi sicuri e inclusivi con laboratori digitali (ICT, robotica, programmazione di base), aree dedicate ad arte, musica e teatro, spazi per giochi sociali, oltre a servizi di orientamento professionale e un calendario mensile di attività culturali e sociali.

Si potrebbero aprire club giovanili in ogni unità amministrativa (Mamurras, Milot, Fushë-Kuqe) con programmi mensili di eventi, e istituire piccoli grant per iniziative promosse da ragazze nei settori dell'arte, media e tecnologia.

Si potrebbero organizzare cicli di formazione “Vajza Lidere” per sviluppare leadership, competenze digitali e mediatiche e sicurezza negli spazi pubblici. Inoltre, i giovani potrebbero essere coinvolti più attivamente attraverso il rafforzamento del Consiglio Giovanile del Comune di Kurbin, partecipando a campagne culturali, dibattiti pubblici, mentoring e tirocini di 1-3 mesi presso imprese locali, con moduli di formazione sulle competenze trasversali.

Fëmijët: mungesë hapësirash lojërash të sigurta dhe mbështetje psikosociale

Në Bashkinë Kurbin, qasja e fëmijëve në hapësira të sigurta dhe zhvillimore është e kufizuar. Në shumicën e lagjeve urbane dhe sidomos në zonat rurale, mungojnë parqet, këndet e lojërave, mjediset rekreative dhe qendrat komunitare, të cilat janë thelbësore për zhvillimin fizik, emocional, social dhe kognitiv të fëmijëve. Fëmijët shpesh luajnë në vende të pasigurta, si rrugë, sheshe të pashtruara ose ambiente informale pa standarde sigurie, duke i ekspozuar ndaj rreziqeve të aksidenteve dhe situatave të pasigurta.

Aktivitetet pas-shkollore janë të pakta, spontane dhe jo sistematike. Shkollat nuk kanë burime të mjaftueshme për programe të strukturuar të artit, sportit, teknologjisë apo zhvillimit social. Mungon një kalendar komunitar aktiviteteve që mund të angazhojë fëmijët në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa familjet, veçanërisht ato në nevojë, nuk kanë mundësi të ofrojnë alternativa private (kurse, aktivitete kulturore, sport-klube).

Situata është më kritike në aspektin e shërbimeve psikosociale. Në shumicën e shkollave mungon prezencë e rregullt e psikologëve, ndërsa në komunitet nuk ka struktura që ofrojnë këshillim, terapi ose ndërhyrje të hershme psiko-emocionale. Kjo është problematike sidomos për fëmijët që: jetojnë në varfëri të thellë; përfshihen në dhunë në familje; kanë humbur një prind për shkak të emigrimit; janë të ekspozuar ndaj sjelljeve të rrezikshme, ose kanë nevojë të veçanta zhvillimore.

Mungesa e këtyre shërbimeve i lë fëmijët të pambrojtur ndaj traumave, vështirësive të të nxënies, problemeve të sjelljes dhe izolimit social.

Krijimi i qendrave dhe hapësirave multifunksionale

Për të përballuar mungesën e shërbimeve për fëmijët në Bashkinë Kurbin, mund të krijoheshin dhe riabilitoheshin kënde lojërash në çdo njësi administrative, duke garantuar siguri dhe aksesueshmëri. Do të ishte e dobishme hapja e qendrave komunitare pas-shkollore me aktivitete edukative në lexim, art, shkencë dhe teknologji, të shoqëruara nga një shërbim psikosocial i lëvizshëm me psikologë që mbulojnë shkollat dhe komunitetet e largëta. Mund të zbatohet një program “Prindërim pozitiv” për familjet vulnerabël, së bashku me fushatë komunitare si “Vajzat luajnë jashtë në siguri” për të sfiduar paragjykimet gjinore dhe për të siguruar hapësira të monitoruara. Për më tepër, mund të organizoheshin trajnime për mësuesit dhe kujdestarët mbi identifikimin e hershëm të rasteve të dhunës dhe nevojave psikosociale të fëmijëve.

Bambini: mancanza di spazi gioco sicuri e supporto psicossociale

Nel Comune di Kurbin, l'accesso dei bambini a spazi sicuri e stimolanti è limitato. Nella maggior parte dei quartieri urbani e soprattutto nelle aree rurali, mancano parchi, aree gioco, spazi ricreativi e centri comunitari, essenziali per lo sviluppo fisico, emotivo, sociale e cognitivo dei bambini. Spesso i bambini giocano in luoghi non sicuri, come strade, piazzali non pavimentati o ambienti informali privi di standard di sicurezza, esponendosi a rischi di incidenti e situazioni pericolose.

Le attività extrascolastiche sono scarse, spontanee e non sistematiche. Le scuole non dispongono di risorse sufficienti per programmi strutturati di arte, sport, tecnologia o sviluppo sociale. Mancano calendari comunitari di attività continue, mentre le famiglie, soprattutto quelle in difficoltà, non possono offrire alternative private (corsi, attività culturali o sportive).

La situazione è più critica sul piano dei servizi psicosociali. Nella maggior parte delle scuole manca la presenza regolare di psicologi, e nella comunità non esistono strutture che forniscano consulenza, terapia o interventi precoci psico-emotivi. Ciò è particolarmente problematico per i bambini che: vivono in condizioni di povertà estrema; subiscono violenza in famiglia; hanno perso un genitore a causa dell'emigrazione; sono esposti a comportamenti a rischio, o hanno bisogni specifici di sviluppo.

La mancanza di questi servizi lascia i bambini vulnerabili a traumi, difficoltà di apprendimento, problemi comportamentali e isolamento sociale.

Creare centri e spazi multifunzionali

Per rispondere alla carenza di servizi per i minori nel comune di Kurbin, si potrebbero creare e riabilitare spazi gioco in ogni unità amministrativa, garantendo sicurezza e accessibilità. Sarebbe utile aprire centri comunitari post-scolastici con attività educative in lettura, arte, scienza e tecnologia, affiancati da un servizio psicosociale itinerante con psicologi che raggiunga scuole e comunità remote. Si potrebbe lanciare un programma di “Genitorialità positiva” per le famiglie vulnerabili, insieme a campagne comunitarie come “Le ragazze giocano fuori in sicurezza” per sfidare stereotipi di genere e assicurare spazi monitorati. Infine, si potrebbero organizzare corsi di formazione per insegnanti e operatori sui segnali precoci di violenza e sui bisogni psicosociali dei bambini.

Të moshuarit: mungesë e qendrave social ditore

Bashkia Kurbin po përballet me një rritje të dukshme të numrit të të moshuarve që jetojnë vetëm, si pasojë e disa faktorëve strukturorë: emigrimi i fëmijëve, varfëria, prishja e familjes tradicionale dhe mungesa e rrjeteve mbështetëse në komunitet. Shpërbërja graduale e modelit të familjes së zgjeruar ka lënë shumë të moshuar pa kujdesin dhe ndihmën që tradicionalisht ofrohej brenda familjes. Pjesa më vulnerabël janë të moshuarit që jetojnë në zonat rurale, ku izolimi gjeografik kombinohet me mungesën e transportit publik, rrugët e amortizuara dhe mungesën e shërbimeve bazë. Këta faktorë i ekspozojnë të moshuarit ndaj rrezikut të depresionit, kequshqyerjes, pasigurisë, varfërisë energjetike dhe pamundësisë për të ndjekur trajtime shëndetësore të vazhdueshme për sëmundjet kronike.

Një sfidë thelbësore në Kurbin është mungesa e qendrave ditore ose hapësirave të dedikuara për të moshuarit, ku ata mund të marrin shërbime psikosociale, aktivitete rekreative, këshillim, orientim shëndetësor ose thjesht të krijojnë lidhje shoqërore. Në mungesë të këtyre strukturave, të moshuarit kalojnë ditë të tëra të izoluar në shtëpi, shpesh pa kontakt me komunitetin dhe pa qasje në informacione të rëndësishme për shëndetin dhe mirëqenien e tyre.

Situata është e rënduar edhe nga mungesa e shërbimeve të kujdesit në shtëpi (home-care), një model shërbimi thelbësor për të moshuarit që kanë vështirësi lëvizjeje, probleme shëndetësore apo mungesë të mbështetjes familjare. Në shumë raste, e vetmja “zgjidhje” për të moshuarit e pambështetur mbetet komshiu, një anëtar i largët i familjes, ose askush.

Program edukimi shëndetësor për vajzat dhe gratë

Për të adresuar mungesën e shërbimeve për të moshuarit në Bashkinë Kurbin, do të mund të krijohej një Qendër Ditore në Laç me shërbime rekreative, psikosociale, fizioterapi të lehtë dhe aktivitete ndërbreznore. Mund të ofrohej shërbime ditore të lëvizshme në Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe për të mbuluar komunitetet më të largëta, si aktivitete sociale dhe shërbim i terrenit. Do të ishte e dobishme vendosja e shërbimeve në banesë (home-care) për të moshuarit që jetojnë vetëm, duke përfshirë vizita periodike, ndihmë për ilaçet, shoqërim te mjeku dhe asistencë për dokumente. Gjithashtu, mund të krijohej një rrjet vullnetarësh të rinj për aktivitete ndërbreznore si lexime, biseda, shoqërim dhe ndihmë digjitale. Për më tepër, do të ishte e nevojshme fuqizimi i procedurave të referimit ndërmjet bashkisë, shërbimeve shëndetësore dhe komunitetit për të siguruar koordinim dhe reagim më të efektshëm.

Anziani: mungesa e centri social diurni

Il Comune di Kurbin si trova ad affrontare un aumento significativo del numero di anziani che vivono soli, a causa di diversi fattori strutturali: l'emigrazione dei figli, la povertà, la disgregazione della famiglia tradizionale e la mancanza di reti di supporto nella comunità. Il progressivo sfaldamento del modello di famiglia estesa ha lasciato molti anziani senza le cure e l'assistenza che tradizionalmente venivano garantite all'interno della famiglia. I più vulnerabili sono gli anziani che vivono nelle aree rurali, dove l'isolamento geografico si combina con la mancanza di trasporto pubblico, strade degradate e assenza di servizi di base. Questi fattori espongono gli anziani al rischio di depressione, malnutrizione, insicurezza, povertà energetica e difficoltà nel seguire cure sanitarie continuative per malattie croniche.

Una sfida fondamentale a Kurbin è la mancanza di centri diurni o spazi dedicati agli anziani, dove essi possano ricevere servizi psicosociali, attività ricreative, consulenza, orientamento sanitario o semplicemente creare relazioni sociali. In assenza di queste strutture, gli anziani trascorrono intere giornate isolati in casa, spesso senza contatto con la comunità e senza accesso a informazioni importanti per la loro salute e benessere.

La situazione è aggravata anche dalla mancanza di servizi domiciliari (home-care), un modello essenziale per gli anziani con difficoltà di mobilità, problemi di salute o mancanza di supporto familiare. In molti casi, l'unica “soluzione” per gli anziani senza sostegno resta il vicino di casa, un familiare lontano o nessuno.

Programma di educazione sanitaria per ragazze e donne

Per rispondere alla mancanza di servizi per gli anziani nel comune di Kurbin, si potrebbe creare un Centro Diurno a Laç con servizi ricreativi, psicosociali, fisioterapia leggera e attività intergenerazionali. Potrebbero essere attivati servizi diurni mobili a Mamurras, Milot e Fushë-Kuqe per raggiungere le comunità più remote, offrendo attività sociali e supporto sul territorio. Sarebbe utile anche fornire servizi domiciliari (home-care) per gli anziani soli, comprendenti visite periodiche, supporto per i farmaci, accompagnamento dal medico e assistenza per le pratiche amministrative. Si potrebbe inoltre creare una rete di volontari giovani per attività intergenerazionali come letture, conversazioni, accompagnamento e supporto digitale. Infine, sarebbe necessario rafforzare le procedure di riferimento tra comune, servizi sanitari e comunità per garantire coordinamento e interventi più efficaci.



Familjet me probleme socio-ekonomike: varfëri, papunësi dhe mungesë transporti

Varfëria e qëndrueshme dhe mungesa e mundësive ekonomike përbëjnë një nga sfidat më të mëdha strukturore për Bashkinë Kurbin.

Zvogëlimi i vendeve të punës, mungesa e bizneseve prodhuese, dominanca e punësimeve me të ardhura të ulëta dhe rritja e kostove të jetesës i vendosin shumë familje në një situatë ekonomike të brishtë. Kjo situatë është veçanërisht e dukshme në njësitë administrative si Gorre, Fushë-Kuqe, Milot dhe Mamurras, ku infrastruktura e kufizuar dhe distancat e mëdha nga qendra administrative e Laçit e intensifikojnë varfërinë dhe pabarazitë.

Një pengesë madhore për familjet me të ardhura të ulëta është mungesa e transportit publik të rregullt, i cili ndikon drejtpërdrejt në aksesin e tyre në: shërbimet bazë publike, tregje dhe punësim ditor, shërbime sociale, qendrat e formimit profesional, shërbimet shëndetësore, dhe institucionet administrative.

Për shumë familje, mungesa e transportit të përballueshëm dhe të aksesueshëm përkthehet në izolim social dhe ekonomik, përjashtim nga shërbimet e mirëqenies dhe pamundësi për të thyer ciklin e varfërisë.

Hapja e pikave të informacionit të shpërndara në territor dhe nisja e programeve mbështetëse për gratë.

Për të përballuar mungesën e shërbimeve në Bashkinë Kurbin, mund të krijoheshin Pika Informimi për qytetarët dhe qytetaret, për të siguruar akses në shërbime sociale, mundësi punësimi, kurse profesionale dhe ndihmë financiare, me sisteme orientimi të veçanta për gratë që kërkojnë punë.

Mund të aktivizohej një program punësimi të përkohshëm komunitar, i menaxhuar nga AKPA dhe Zyra e Punës, i lidhur me trajnime profesionale dhe aktivitete në shërbime komunitare.

Gjithashtu, mund të parashikoheshin subvencione transporti për gratë dhe vajzat që ndjekin kurse, trajnim profesional ose punë sezonale, duke garantuar kështu akses më të madh dhe përfshirje ekonomike.

Famiglie con problemi socio-economici: povertà, disoccupazione e mancanza di trasporti

La povertà persistente e la mancanza di opportunità economiche rappresentano una delle sfide strutturali più importanti per il Comune di Kurbin.

La riduzione dei posti di lavoro, l'assenza di imprese produttive, la predominanza di occupazioni a basso reddito e l'aumento del costo della vita pongono molte famiglie in una situazione economica fragile. Questa condizione è particolarmente evidente nelle unità amministrative di Gorre, Fushë-Kuqe, Milot e Mamurras, dove l'infrastruttura limitata e le grandi distanze dal centro amministrativo di Laç intensificano povertà e disuguaglianze.

Un ostacolo significativo per le famiglie a basso reddito è la mancanza di trasporto pubblico regolare, che incide direttamente sull'accesso a servizi pubblici di base, mercati e occupazioni giornaliere, servizi sociali, centri di formazione professionale, servizi sanitari e istituzioni amministrative.

Per molte famiglie, l'assenza di trasporto accessibile ed economico si traduce in isolamento sociale ed economico, esclusione dai servizi di welfare e impossibilità di rompere il ciclo della povertà.

Aprire punti di informazione diffusi sul territorio e avviare programmi di sostegno per le donne

Per rispondere alla carenza di servizi nel comune di Kurbin, si potrebbero creare Punti di informazione per i cittadini e le cittadine, per offrire accesso a servizi sociali, opportunità di impiego, corsi professionali e assistenza finanziaria, con sistemi di orientamento specifici per le donne in cerca di lavoro.

Potrebbe essere attivato un programma di lavoro temporaneo comunitario, gestito da AKPA e dall'Ufficio del Lavoro, collegato a percorsi di formazione professionale e attività nei servizi comunitari.

Inoltre, si potrebbero prevedere sovvenzioni per il trasporto destinate a donne e ragazze che partecipano a corsi, percorsi di formazione o lavori stagionali, garantendo così maggiore accessibilità e inclusione economica.



Personat me aftësi të kufizuara: mungesë shërbimesh dhe përfshirje sociale

Në Bashkinë Kurbin, mungesa e qendrave ditore dhe e shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara (PAK) përbën një sfidë të madhe për përfshirjen dhe autonominë e tyre.

Infrastruktura publike dhe institucionet nuk janë të adaptuara për akses fizik, ndërsa mungon koordinimi ndërmjet bashkisë, shëndetësisë dhe arsimit për ofrimin e mbështetjes së integruar.

Në zonat rurale, PAK shpesh varen plotësisht nga kujdesi familjar dhe përjashtohen nga mundësitë arsimore dhe punësimi, duke e kufizuar më tej pjesëmarrjen e tyre sociale.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim të dyfishtë, duke u ekspozuar ndaj dhunës, varfërisë dhe izolimit social. Për më tepër, nënat që kujdesen për fëmijë me aftësi të kufizuara mbajnë barrën kryesore të kujdesit, shpesh pa mbështetje financiare, psikosociale apo shërbime asistence.

Një qasje gjinore ndaj politikave dhe shërbimeve për PAK do të kërkonte integrimin e mbështetjes për kujdestaret gra dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të grave me aftësi të kufizuara në jetën publike, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse që redukton paparazitë dhe promovon autonominë.

Buxheti gjinor dhe mbështetja ligjore

Në themel të zgjidhjeve të qëndrueshme qëndron përcaktimi i prioriteteve të duhura në buxhetet vendore. Kjo do të thotë se Bashkia duhet të integrojë analiza gjinore në hartimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare, duke siguruar që gratë dhe vajzat të mos mbeten të përjashtuara.

Ndërtimi i kapaciteteve për buxhetim të ndjeshëm gjinor, zhvillimi i treguesve matës për efektin gjinor të investimeve publike dhe përfshirja e përfaqësuesve të grave në procesin buxhetor, do të garantojnë që asnjë zë në buxhet të mos jetë “i verbër” ndaj nevojave reale të grave.

Buxheti gjinor siguron që burimet publike të shpërndahen në mënyrë të barabartë, duke iu përgjigjur nevojave specifike të grave, ndërsa mbështetja ligjore garanton që këto burime dhe të drejta të jenë vërtet të aksesueshme, duke i mbrojtur gratë nga diskriminimi dhe dhuna.

Persone con disabilità: mancanza di servizi e inclusione sociale.

Nel Comune di Kurbin, la mancanza di centri diurni e di servizi di supporto per le persone con disabilità rappresenta una sfida significativa per la loro inclusione e autonomia.

Le infrastrutture pubbliche e le istituzioni non sono adeguate all'accesso fisico, mentre manca un coordinamento tra il comune, i servizi sanitari e il sistema educativo per offrire un sostegno integrato.

Nelle aree rurali, le persone con disabilità dipendono spesso interamente dalla cura familiare ed sono escluse dalla formazione e dall'occupazione, limitando ulteriormente la loro partecipazione sociale.

Donne e ragazze con disabilità affrontano una doppia discriminazione, esponendosi a rischi maggiori di violenza, povertà e isolamento. Inoltre, le madri che si prendono cura di figli con disabilità sopportano il peso principale dell'assistenza, spesso senza supporto finanziario, psicologico o servizi dedicati.

Un approccio di genere alle politiche e ai servizi per le disabilità richiederebbe l'integrazione del supporto alle caregiver donne e la promozione della partecipazione attiva delle donne con disabilità alla vita pubblica, garantendo un approccio inclusivo che riduca le disuguaglianze e favorisca l'autonomia.

Gender budgeting e accompagnamento legale

Alla base di soluzioni sostenibili vi è la definizione delle giuste priorità nei bilanci locali. Ciò significa che il Comune deve integrare analisi di genere nella pianificazione e distribuzione delle risorse finanziarie, assicurando che donne e ragazze non vengano escluse.

La costruzione di capacità per un budgeting sensibile al genere, lo sviluppo di indicatori per misurare l'impatto di genere degli investimenti pubblici e il coinvolgimento di rappresentanti delle donne nel processo di bilancio garantiranno che nessuna voce di bilancio sia “cieca” rispetto ai reali bisogni delle donne.

Il gender budgeting assicura che le risorse pubbliche siano allocate in modo equo, rispondendo ai bisogni specifici delle donne, mentre il sostegno legale garantisce che queste risorse e diritti possano essere effettivamente accessibili, proteggendo le donne da discriminazioni e violenze.



1



1

Mentaliteti patriarkal

Normat patriarkale mbeten thellësisht të rrënjosura në kulturën shoqërore të Kurbin. Shprehje si “gruaja duhet të durojë” ose “problemet e shtëpisë nuk nxirren jashtë” vazhdojnë të përdoren për të legjitimuar dhunën dhe për të heshtur zërin e grave.

Këto vlera tradicionale krijojnë një mjedis ku dhuna shihet si mjet disipline ose si pjesë “normale” e jetës familjare, duke e normalizuar dhe fshehur nga institucionet. Gratë që guxojnë të denoncojnë shpesh përballen me gjykim, turpërim dhe izolim nga komuniteti ose familja e zgjeruar.

Vajzat rriten në një atmosferë ku autoriteti mashkullor konsiderohet suprem, liria personale është e kufizuar dhe martesë e hershme shihet ende si një rrugëdalje “e sigurt”.

Ky mentalitet i ngurtë, ku dhuna pranohet në mënyrë të heshtur, ka bërë që breza të tërë të mos e shohin dhunën si krim, por si rutinë, duke riprodhuar pabarazinë gjinore brez pas brezi.

Hapja e një biblioteke komunitare

Për t’u përballur me normat patriarkale dhe përhapjen e dhunës gjinore në Bashkinë Kurbin, mund të implementoheshin disa veprime të ndërlidhura. Mund të nisë një fushatë e gjerë ndërgjegjësimi “Kurbin pa Dhunë”, duke përfshirë shkollat, mediat lokale, rrjetet sociale dhe komunitetet fetare, për të ndryshuar perceptimet shoqërore dhe për të promovuar një kulturë respekti.

Në shkollat mund të zhvillohen programe edukimi gjinor mbi marrëdhënie të shëndetshme, respektimin e të drejtave dhe mënyra të sigurta për të raportuar abuzimet.

Mund të organizohen workshop-e “Burrat Aleatë” për burrat dhe djemtë, duke përfshirë ekipe sportive, punëtorë dhe udhëheqës komuniteti, për të promovuar kode sjelljeje respektuese edhe në vendin e punës. Gjithashtu, do të ishte e dobishme të trajnohet stafi i vijës së parë, mësues, mjekë, policë dhe punonjës bashkie, mbi komunikimin jo-stigmatizues dhe procedurat e referimit të sigurt për viktimat, duke siguruar një qasje të integruar parandalimi dhe mbrojtjeje.

Mentalità patriarcale

Le norme patriarcali rimangono profondamente radicate nella cultura sociale di Kurbin. Espressioni come “la donna deve sopportare” o “i problemi di casa non si portano fuori” continuano a essere utilizzate per legittimare la violenza e per zittire la voce delle donne.

Questi disvalori tradizionali creano un ambiente in cui la violenza è vista come strumento di disciplina o come parte “normale” della vita familiare, normalizzandola e nascondendola alle istituzioni. Le donne che osano denunciare spesso affrontano giudizio, vergogna e isolamento da parte della comunità o della famiglia allargata.

Le ragazze crescono in un’atmosfera in cui l’autorità maschile è considerata suprema, la libertà personale è limitata e il matrimonio precoce è ancora percepito come una via “sicura”.

Questa rigida mentalità, in cui la violenza è tacitamente accettata, ha portato intere generazioni a non considerare la violenza come un crimine, ma come routine, riproducendo la disuguaglianza di genere di generazione in generazione.

Apertura di una biblioteca comunitaria

Per rispondere alla diffusione delle norme patriarcali e alla persistenza della violenza di genere nel comune di Kurbin, si potrebbero implementare diverse azioni complementari. Potrebbe essere avviata una vasta campagna di sensibilizzazione “Kurbin pa Dhunë”, coinvolgendo scuole, media locali, social network e comunità religiose, per modificare le percezioni sociali e promuovere una cultura di rispetto.

Nelle scuole si potrebbero introdurre programmi di educazione di genere, incentrati su relazioni sane, rispetto dei diritti e modalità sicure di segnalazione di abusi.

Si potrebbero organizzare workshop “Burrat Aleatë” per uomini e ragazzi, coinvolgendo squadre sportive, operatori e leader comunitari, al fine di promuovere codici di comportamento rispettosi anche nei luoghi di lavoro. Inoltre, sarebbe utile formare il personale di prima linea, insegnanti, medici, agenti di polizia e funzionari comunali, su comunicazione non stigmatizzante e procedure di referral sicure per le vittime, garantendo un approccio integrato di prevenzione e protezione.



Mbështetje e pamjaftueshme nga komuniteti dhe institucionet

Një nga sfidat kryesore për gratë që përballen me dhunë në Bashkinë Kurbin është mungesa e mbështetjes efektive nga institucionet dhe komuniteti. Shpesh, gratë që kërkojnë ndihmë përballen me procedura të ngadalta dhe të ndërlikuara, mungesë koordinimi mes policisë, shërbimeve shëndetësore, shërbimeve sociale dhe gjykatave, si dhe vonesa në lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.

Në këtë kontekst të brishtë, çdo vonesë mund të ketë pasoja serioze, madje fatale. Shumë gra përjetojnë gjithashtu “viktimizim të dytë”, kur institucionet i paragjykojnë, i pyesin në mënyrë akuzuese ose relativizojnë dhunën që kanë përjetuar.

Mungesa e besimit tek institucionet bën që shumë gra të mos kërkojnë fare ndihmë, ndërsa vajzat rriten me perceptimin se sistemet publike nuk funksionojnë për ta.

Ky fenomen dobëson jo vetëm mundësinë e grave për të pasur qasje në mbrojtje dhe drejtësi, por edhe riprodhon pabarazinë gjinore, duke krijuar një cikël izolimi, cënueshmërie dhe mungese besimi që mund të zgjasë breza pas brezi.

Hapja e një biblioteke komunitare

Për të përmirësuar mbështetjen ndaj grave që përballen me dhunë në Bashkinë Kurbin, mund të rifunksionalizohet plotësisht MKR, duke organizuar mbledhje mujore, duke përditësuar protokollat dhe duke afishuar rrugët e referimit në institucionet publike.

Mund të krijohet një Zyrë “Një-Ndalesë” në bashki, e pajisur me psikologë, punonjës socialë dhe juristë, me regjistrë elektronik të rasteve dhe referim të menjëhershëm drejt shërbimeve të specializuara.

Do të ishte e dobishme të organizoheshin trajnime ndërinstitutionale mbi vlerësimin e rrezikut, mbledhjen e provave, lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe komunikimin me viktimat pa stigmatizim.

Gjithashtu, mund të vendosej një oficer/e kontakti 24/7, me protokoll konfidencialiteti dhe auditim periodik për garantimin e cilësisë së shërbimeve.

Sostegno insufficiente da parte della comunità e delle istituzioni

Una delle sfide principali per le donne che subiscono violenza nel Comune di Kurbin è la mancanza di un sostegno efficace sia da parte delle istituzioni sia della comunità. Spesso, le donne che cercano aiuto si trovano a dover affrontare procedure lente e complesse, una scarsa coordinazione tra polizia, servizi sanitari, assistenza sociale e tribunali, e ritardi nell'emissione di ordini di protezione.

In questo contesto fragile, ogni ritardo può avere conseguenze gravi, talvolta anche fatali. Molte donne sperimentano inoltre la cosiddetta “vittimizzazione secondaria”, quando le istituzioni le giudicano, pongono domande in modo accusatorio o minimizzano la gravità della violenza subita.

La carenza di fiducia nelle istituzioni porta molte donne a non chiedere affatto aiuto, mentre le ragazze crescono con la percezione che i sistemi pubblici non funzionino per loro. Questo fenomeno indebolisce non solo la capacità delle donne di accedere a protezione e giustizia, ma perpetua anche la disuguaglianza di genere, creando un circolo di isolamento, vulnerabilità e sfiducia che può durare per generazioni.

Rinforzare il meccanismo di riferimento

Per migliorare il sostegno alle donne che subiscono violenza nel Comune di Kurbin, si potrebbe rifunionalizzare completamente il MKR, organizzando riunioni mensili, aggiornando i protocolli e affiggendo le procedure di riferimento negli enti pubblici.

Potrebbe essere creata un “Ufficio One-Stop” in Comune, dotato di psicologi, assistenti sociali e giuristi, con registro elettronico dei casi e possibilità di riferimento immediato ai servizi specializzati.

Sarebbe utile organizzare formazione interistituzionale sulla valutazione del rischio, raccolta delle prove, emissione di ordini di protezione e comunicazione con le vittime senza stigmatizzazione.

Inoltre, si potrebbe istituire un/una ufficiale di contatto disponibile 24/7, con protocolli di riservatezza e audit periodici per garantire la qualità dei servizi.



Mungesa e qendrës së grave të dhunuara (strehim & rehabilitim)

Në Bashkinë Kurbin mungon një qendër strehimi dhe rehabilitimi për gratë dhe vajzat që përballen me dhunë.

Ky është një boshllëk kritik, pasi strehimi emergjent është elementi i parë dhe më i domosdoshëm për mbrojtjen e viktimave. Pa një vend të sigurt për t'u strehuar, shumë gra detyrohen të rikthehen te dhunuesi, duke e bërë rrethin e dhunës të pashmangshëm.

Mungesa e strehimit ul efektivitetin edhe të urdhrave të mbrojtjes dhe të punës së policisë. Gratë që largohen nga dhuna përballen me pasiguri, mungesë ushqimi, vështirësi për kujdesin ndaj fëmijëve dhe mungesë mbështetjeje emocionale.

Riintegrimi bëhet pothuajse i pamundur pa shërbime psikosociale, këshillimore dhe ekonomike. Kjo situatë jo vetëm që dëmton shëndetin mendor dhe fizik të grave, por e rrit rrezikun për rikthim në dhunë dhe trauma të përsëritura.

Hapja e një qendre të parë pritjeje për gratë viktimë të dhunës

Hapja e një Qendre Ditore me një Apartament Strehimi Emergjent (nga 72 orë deri në 3 muaj) me staf të specializuar përbën një hap kyç për mbrojtjen e menjëhershme të grave viktimë të dhunës.

Shërbimi duhet të shoqërohet me një linjë telefonike 24/7 dhe një numër emergjence të afishuar qartë në komunitet. Paralelisht, duhet të ofrohet një paketë riintegrimi që përfshin bonus qiraje (6–12 muaj), kuponë për trajnim profesional, kontrata punësimi dhe mbështetje për fëmijët.

Po ashtu, është e nevojshme krijimi i një Fondi të Urgjencës pranë bashkisë për mbulimin e shpenzimeve imediate si ushqim, medikamente, transport apo dokumente, si dhe lidhja me strehat rajonale e kombëtare për rastet që kërkojnë strehim afatgjatë.

Mancanza di un centro per donne vittime di violenza (accoglienza e riabilitazione)

Nel Comune di Kurbin manca un centro di accoglienza e riabilitazione per le donne e le ragazze che subiscono violenza.

Si tratta di una lacuna critica, poiché l'alloggio d'emergenza rappresenta il primo e più indispensabile passo per la protezione delle vittime. Senza un luogo sicuro dove rifugiarsi, molte donne sono costrette a tornare dal proprio aggressore, rendendo il ciclo della violenza praticamente inevitabile.

L'assenza di strutture di accoglienza riduce anche l'efficacia degli ordini di protezione e del lavoro della polizia. Le donne che cercano di sfuggire alla violenza si trovano ad affrontare situazioni di insicurezza, mancanza di cibo, difficoltà nella cura dei figli e assenza di sostegno emotivo.

Il reinserimento diventa quasi impossibile senza servizi psicosociali, di consulenza e di supporto economico. Questa situazione non solo compromette la salute fisica e mentale delle donne, ma aumenta anche il rischio di ritorno alla violenza e di traumi ripetuti.

Apertura di un centro di prima accoglienza per donne vittime di violenza

L'apertura di un Centro Diurno con un Appartamento di Accoglienza Emergenziale (per un periodo da 72 ore fino a 3 mesi) dotato di personale specializzato rappresenta una risposta fondamentale per la protezione immediata delle donne vittime di violenza.

Il servizio dovrebbe essere integrato da una linea telefonica attiva 24/7 e da un numero di emergenza ben visibile all'interno della comunità. A questo si affianca una pacchetto di reintegrazione che includa un bonus affitto (6–12 mesi), voucher per la formazione professionale, contratti di lavoro e sostegno per i figli.

È inoltre necessario istituire un Fondo di Emergenza comunale per coprire spese urgenti come alimenti, farmaci, trasporti e documentazione, nonché garantire collegamenti efficaci con rifugi regionali e nazionali per i casi che richiedono un'accoglienza a lungo termine.



Mospërputhja midis arsimit dhe kërkesave të tregut të punës

Në Bashkinë Kurbin, arsimi nuk është i harmonizuar me nevojat reale të tregut të punës. Shkollat e mesme vazhdojnë të ofrojnë drejtime tradicionale që nuk pasqyrojnë sektorët që po zhvillohen në ekonomi, si turizmi, agropërpunimi, shërbimet teknike, ndërtimi, teknologjia e informacionit apo bujqësia e mekanizuar.

Mungon një analizë sistematike e kërkesës për aftësi dhe një mekanizëm bashkëpunimi shkollë–biznes që të udhëzonte zhvillimin e kurrikulave. Nga ana tjetër një barrierë drejt punësimit është mungesa e praktikave profesionale të strukturara, të cilat, edhe kur ekzistojnë, janë të shkurtëra, formale dhe nuk ofrojnë aftësi të përdorshme në punë.

Si pasojë, të rinjtë diplomohen pa aftësi praktike, ndërsa bizneset lokale raportojnë mungesë punëtorësh të kualifikuar.

Ky hendek krijon papunësi të qëndrueshme, nxit emigrimin dhe dobëson bazën ekonomike të bashkisë. Problemi është veçanërisht i theksuar tek grave dhe tek të rinjtë, të cilët nuk shohin perspektivë profesionale në territor dhe e shohin emigrimin si zgjedhjen e vetme.

Hartëzimi i kompetencave dhe veprimet mbështetëse

Për ta afruar arsimin me nevojat reale të tregut të punës në Bashkinë Kurbin, kërkohet një strategji e integruar që lidh shkollat, bizneset dhe institucionet vendore. Një hap i parë thelbësor do të ishte realizimi i një “hartëzimi të aftësive të kërkuara” (skills mapping) në bashkëpunim me bizneset e zonës, me qëllim identifikimin e profesioneve dhe aftësive më të kërkuara. Bazuar në këto të dhëna, duhet të bëhet një përditësim i kurrikulave shkollore, duke u përqendruar në sektorët prioritarë si agroturizmi, teknologjitë e informacionit, shërbimet, ndërtimi dhe bujqësia e mekanizuar.

Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm ka të bëjë me promovimin e pjesëmarrjes së vajzave në drejtimet teknike dhe artizanale, përmes fushatës “Vajzat në Zanate”, e cila mund të nxjerrë në pah modele suksesi femëror, të organizojë vizita shkollore në biznese lokale dhe të krijojë laboratorë prove që i afrojnë vajzat me realitetin e tregut të punës.

Së fundi, krijimi i bursave ose i stimuljeve ekonomike për vajzat që ndjekin profile teknike do të kontribuonte në uljen e hendekut gjinor në tregun e punës dhe në forcimin e potencialit ekonomik të territorit.

Disallineamento tra istruzione e richieste del mercato del lavoro

Nel Comune di Kurbin, il sistema educativo non è armonizzato con le reali esigenze del mercato del lavoro. Le scuole superiori continuano a offrire indirizzi tradizionali che non riflettono i settori in crescita dell'economia, come il turismo, l'agroindustria, i servizi tecnici, l'edilizia, la tecnologia dell'informazione o l'agricoltura meccanizzata.

Manca un'analisi sistematica della domanda di competenze e un meccanismo di collaborazione tra scuola e imprese che possa orientare lo sviluppo dei curricula.

Un'ulteriore barriera all'occupazione è rappresentata dalla mancanza di tirocini professionali strutturati che, anche quando esistono, sono spesso brevi, formali e non forniscono competenze realmente spendibili nel mondo del lavoro. Di conseguenza, i giovani si diplomano senza abilità pratiche, mentre le imprese locali segnalano una carenza di lavoratori qualificati.

Questo divario genera una disoccupazione persistente, alimenta l'emigrazione e indebolisce la base economica del comune. Il problema è particolarmente grave tra le donne e i giovani, che non vedono prospettive professionali nel territorio e considerano l'emigrazione come l'unica via possibile.

Mappatura delle competenze e azioni di sostegno

Per avvicinare l'istruzione alle reali esigenze del mercato del lavoro nel Comune di Kurbin, è necessaria una strategia integrata che colleghi scuole, imprese e istituzioni locali. Un primo passo fondamentale sarebbe la realizzazione di una “mappatura delle competenze richieste” (skills mapping) in collaborazione con le imprese del territorio, al fine di individuare le professioni e le abilità più richieste. Sulla base di questi dati, occorrerebbe procedere con un aggiornamento dei curricula scolastici, concentrandosi sui settori prioritari come agriturismo, tecnologie dell'informazione, servizi, edilizia e agricoltura meccanizzata.

Un aspetto particolarmente importante riguarda la promozione della partecipazione delle ragazze ai percorsi tecnici e artigianali, attraverso la campagna “Ragazze nei Mestieri”, che potrebbe valorizzare modelli di successo femminile, organizzare visite scolastiche presso imprese locali e attivare laboratori di prova che avvicinino le studentesse al mondo reale del lavoro. Infine, la creazione di borse di studio o incentivi economici per le ragazze iscritte a indirizzi tecnici contribuirebbe a ridurre il divario di genere nel mercato del lavoro e a rafforzare il potenziale economico del territorio.



Pengesat struktureore për gratë dhe vajzat në zonat rurale (transporti, informimi, kujdesi familjar)

Në zonat rurale të Kurbinit, gratë dhe vajzat përballen me barriera të shumëfishta, të cilat i përjashtojnë nga arsimimi profesional, praktikat dhe punësimi.

Mungesa e transportit publik e bën pothuajse të pamundur lëvizjen drejt Laçit apo qendrave trajnuese. Informacioni mbi kurset, vendet e punës dhe programet e mbështetjes nuk u mbërrin rregullisht vajzave në fshat, veçanërisht atyre që nuk kanë akses të qëndrueshëm në internet.

Ngarkesa e lartë e punëve familjare dhe e kujdesit për fëmijët bie pothuajse plotësisht mbi gratë dhe vajzat, duke u hequr kohën dhe mundësinë për të ndjekur kurse apo për të punuar.

Këto kushte krijojnë një mjedis të izoluar ekonomik, ku gratë kanë pak mundësi për të zhvilluar aftësi të reja dhe për të fituar të ardhura. Për pasojë, pabarazia gjinore përforcohet, ndërsa potenciali i grave dhe vajzave mbetet i pashfrytëzuar.

Qasje në transport dhe aktivizimi i rrugëve të trajnimit mobile

Për të nxitur përfshirjen socio-ekonomike të grave në zonat rurale, mund të zbatohet një grup i integruar veprimesh që adreson njëkohësisht barrierat logjistike, informative dhe arsimore.

Së pari, krijimi i një linje transporti publik midis fshatrave dhe Laçit, me orare të përshtatura sipas nevojave të pjesëmarrëseve, do të lehtësonte lëvizjen dhe do të shmangte vështirësitë e transportit.

Paralelisht, organizimi i kurseve profesionale mobile drejtpërdrejt në fshatra, në sektorë si gatimi, qepja, teknologjitë e informacionit dhe agroturizmi, do të mundësonte zhvillimin e aftësive praktike pa kërkuar udhëtime të gjata.

Për të siguruar pjesëmarrjen efektive, këto aktivitete duhet të shoqërohen me subvencione për transportin dhe shërbime kujdesi për fëmijët gjatë trajnimeve, duke reduktuar barrën e detyrimeve familjare. Së fundi, një sistem i gjerë informimi, i bazuar në grupe WhatsApp/Viber dhe ekrane informacioni lokal, do të garantojë që gratë të jenë vazhdimisht të informuara mbi kurset, mundësitë dhe shërbimet në dispozicion, duke krijuar një ekosistem mbështetës që vlerëson si aftësitë individuale ashtu edhe kohezionin komunitar.

Barriere strukturali per donne e ragazze nelle aree rurali (trasporti, informazione, cura della famiglia)

Nelle aree rurali del Comune di Kurbin, donne e ragazze affrontano molteplici barriere che le escludono dalla formazione professionale, dai tirocini e dall'occupazione.

La mancanza di trasporto pubblico rende quasi impossibile spostarsi verso Laç o verso i centri di formazione. Le informazioni su corsi, posti di lavoro e programmi di supporto non raggiungono regolarmente le ragazze nei villaggi, in particolare quelle senza accesso stabile a internet.

L'elevato carico di lavori domestici e di cura dei bambini ricade quasi interamente sulle donne e sulle ragazze, limitando tempo e opportunità per frequentare corsi o lavorare.

Queste condizioni creano un ambiente di isolamento economico, in cui le donne hanno poche possibilità di acquisire nuove competenze e generare reddito. Di conseguenza, le disuguaglianze di genere si rafforzano e il potenziale di donne e ragazze resta in gran parte inutilizzato.

Accesso ai trasporti e attivazione di percorsi formativi mobili

Per favorire l'inclusione socio-economica delle donne nelle aree rurali, è possibile implementare un insieme integrato di azioni che affronti simultaneamente le barriere logistiche, informative e formative.

In primo luogo, l'istituzione di una linea di trasporto pubblico tra i villaggi e Laç, con orari studiati sulle esigenze delle partecipanti, permetterebbe di superare le difficoltà di spostamento.

Parallelamente, la realizzazione di corsi professionali mobili direttamente nei villaggi, nei settori della cucina, della sartoria, delle tecnologie dell'informazione e dell'agroturismo, consentirebbe di sviluppare competenze pratiche senza richiedere lunghi trasferimenti.

Per rendere effettiva la partecipazione, queste attività dovrebbero essere accompagnate da sussidi per il trasporto e servizi di cura dei bambini durante le sessioni formative, riducendo il peso degli obblighi familiari.

Infine, un sistema di comunicazione capillare, basato su gruppi WhatsApp/Viber e schermi informativi locali, garantirebbe che le donne siano costantemente informate su corsi, opportunità e servizi disponibili, creando un ecosistema di supporto integrato che valorizza sia le capacità individuali sia la coesione comunitaria.

Mungesa e qendrave të kurseve profesionale në Kurbin

Mungesa e qendrave funksionale të formimit profesional në Bashkinë Kurbin përbën një ndër pengesat më të mëdha për zhvillimin e aftësive të punës, punësueshmërinë dhe pavarësinë ekonomike të banorëve.

Aktualisht, shumica e kurseve profesionale ofrohen vetëm në qytetet fqinje, Lezhë, Tiranë apo Shkodër, ndërsa territori i Kurbin, veçanërisht zonat rurale, mbetet pa infrastrukturë trajnuese, pa pajisje dhe pa instruktorë të specializuar.

Kjo situatë kufizon rëndë mundësinë e të rinjve dhe të rriturve për të fituar aftësi praktike në profesione të kërkuara në treg, si mekanikë, elektrikistë, kuzhinierë, rrobaqepëse, kujdestarë socialë, punonjës turizmi apo përpunues të produkteve bujqësore.

Mungesa e qendrave lokale të trajnimit ul nivelin e kualifikimit të forcës punëtore, forcon varësinë nga punët informale dhe vështirëson zhvillimin ekonomik të zonës. Bizneset në Kurbin raportojnë mungesë të punonjësve të kualifikuar, ndërsa të rinjtë ankohen se nuk kanë ku të formohen. Ky boshllëk krijon një cikël të mbyllur migrimi, papunësie dhe varfërie, duke frenuar zhvillimin socio-ekonomik të bashkisë.

Ofrimi kurse profesionale specifike për gratë dhe vajzat

Për të përmirësuar qasjen e grave dhe të rinjve në zonat rurale ndaj formimit profesional dhe zhvillimit të aftësive praktike, mund të ndërmerren një sërë veprimesh të integruara.

Krijimi i qendrave satelitore të formimit profesional në çdo njësi administrative (Mamurras, Milot, Fushë-Kuqe) do të sjellë strukturë dhe afërsi fizike për pjesëmarrësit. Hapja e laboratorëve praktikë për profesione si kuzhinë, rrobaqepsi, mekanikë, teknologji informacioni, agroturizëm dhe kujdes social, do të sigurojë mësim praktik të nivelit të lartë.

Për t'u përshtatur me zonat më të largëta, mund të organizohen trajnime “mobile” që lëvizin në fshatra, me kurse 6–8 javore, të shoqëruara nga një program i subvencionuar transporti dhe shërbimi i kujdesit për fëmijët, duke lehtësuar pjesëmarrjen e vajzave dhe grave. Përdorimi pasdites i klasave shkollore për trajnime, partneriteti me shkollat dhe angazhimi i instruktorëve itinerantë dhe ekspertëve lokalë do të rrisin kapacitetet dhe ekspertizën e ofruar.

Së fundi, fushata të gjera informimi në komunitetet rurale do të sigurojnë që vajzat të jenë të informuara për mundësitë e formimit profesional, duke krijuar një rrjet mbështetës që promovon aftësim, punësueshmëri dhe zhvillim socio-ekonomik lokal.

Mancanza di centri per corsi professionali a Kurbin

La mancanza di centri funzionali di formazione professionale nel Comune di Kurbin rappresenta uno dei principali ostacoli allo sviluppo delle competenze lavorative, all'occupabilità e all'indipendenza economica dei residenti. Attualmente, la maggior parte dei corsi professionali viene offerta solo nelle città vicine, come Lezhë, Tirana o Shkodër, mentre il territorio di Kurbin, in particolare le aree rurali, resta privo di infrastrutture formative, di attrezzature e di istruttori specializzati.

Questa situazione limita fortemente la possibilità per giovani e adulti di acquisire competenze pratiche in professioni richieste dal mercato, come meccanici, elettricisti, cuochi, sarti, operatori sociali, addetti al turismo o trasformatori di prodotti agricoli.

La mancanza di centri di formazione locali abbassa il livello di qualificazione della forza lavoro, rafforza la dipendenza dal lavoro informale e ostacola lo sviluppo economico della zona. Le imprese di Kurbin segnalano carenza di personale qualificato, mentre i giovani lamentano l'assenza di opportunità di formazione. Questo vuoto crea un circolo vizioso di migrazione, disoccupazione e povertà, frenando lo sviluppo socio-economico.

Offrire corsi professionali specifici per donne e ragazze

Per migliorare l'accesso di donne e giovani nelle aree rurali alla formazione professionale e allo sviluppo di competenze pratiche, possono essere intraprese una serie di azioni integrate. La creazione di centri satelliti di formazione professionale in ciascuna unità amministrativa (Mamurras, Milot, Fushë-Kuqe) garantirebbe strutture vicine ai partecipanti. L'apertura di laboratori pratici per professioni richieste, come cucina, sartoria, meccanica, tecnologie informatiche, agroturismo e servizi sociali, permetterebbe un apprendimento pratico di alto livello.

Per adattarsi alle zone più remote, si potrebbero organizzare corsi “mobili” che si spostano nei villaggi, della durata di 6–8 settimane, accompagnati da un programma di trasporto sovvenzionato e servizi di cura dei bambini, facilitando la partecipazione di ragazze e donne. L'utilizzo pomeridiano delle aule scolastiche per le formazioni, la collaborazione con le scuole e il coinvolgimento di istruttori itineranti ed esperti locali aumenterebbero capacità e competenze offerte.

Infine, campagne di informazione capillari nelle comunità rurali garantirebbero che le ragazze siano informate sulle opportunità di formazione professionale, creando una rete di supporto che promuove competenze, occupabilità e sviluppo socio-economico locale.



Mungesa e informacionit për programet e nxitjes së punësimit nga AKPA dhe Zyra e Punës

Mungesa e informacionit të qartë, të aksesueshëm dhe të shpërndarë gjerësisht mbi programet e nxitjes së punësimit përbën një nga pengesat më serioze për integrimin ekonomik të grave dhe vajzave në Bashkinë Kurbin. Edhe pse ZVAP/AKPA ofrojnë një gamë të gjerë programesh, kurse profesionale, grante për nisma vetëpunësimi, skema praktike, punësim me subvencion pagash, programe sezonale dhe orientim karriere, të dhënat tregojnë se një pjesë e madhe e popullsisë nuk është në dijeni të këtyre mundësive.

Shpërndarja e informacionit mbetet shumë e kufizuar. Njoftimet bëhen kryesisht përmes platformave online, rrjeteve sociale ose afisheve të vendosura fizikisht në Zyrën e Punës në Laç. Këto forma komunikimi nuk mbulojnë gjithë territorin e bashkisë dhe nuk adresojnë nevojat e grave dhe vajzave që jetojnë në zona rurale si Gorre, Fushë-Kuqe, Milot, Mamurras apo në lagje të izoluar me infrastrukturë të dobët.

Për shumë prej tyre, distanca fizike nga institucionet, mungesa e transportit dhe e internetit, ose mungesa e pajisjeve digjitale, e bëjnë të pamundur aksesin në informacionin zyrtar.

Veprime të koordinuara të informimit dhe ndërgjegjësimit

Për të përmirësuar qasjen e grave dhe vajzave në zonat rurale ndaj mundësive të punësimit dhe formimit profesional, mund të ndërmerren një sërë veprimesh të koordinuara.

Krijimi i një Rrjeti Informimi “Kurbin Punëson”, i bazuar në WhatsApp/Viber dhe faqen e Facebook-ut të bashkisë, do të sigurojë njoftime të rregullta mbi kurset, praktikant dhe vendet e lira të punës.

Vendosja e këndeve të informacionit në çdo njësi administrative, si shkolla, qendra komunitare dhe zyrat e bashkisë, do të ofrojë pika qasjeje fizike për të gjithë qytetarët. Fushata informuese në terren, përmes takimeve komunitare dhe vizitave derë më derë për gratë në fshatra, do të rrisë ndërgjegjësimin mbi mundësitë ekzistuese. Njoftimet e personalizuar për vajzat e papuna, të realizuara në bashkëpunim me ZVAP dhe shkollat e mesme, do të synojnë nevojat specifike të kësaj grupmoshe, ndërsa partneriteti me organizata joqeveritare do të lehtësojë shpërndarjen e informacionit tek gratë më vulnerabël.

Këto veprime të kombinuara do të krijojnë një sistem të integruar informimi, duke rritur qasjen, pjesëmarrjen dhe mundësitë për punësim dhe aftësim profesional.

Mancanza di informazioni sui programmi di promozione dell'occupazione dell'AKPA e dell'Ufficio del Lavoro

La mancanza di informazioni chiare, accessibili e diffuse sui programmi di promozione dell'occupazione rappresenta uno degli ostacoli più seri per l'integrazione economica di donne e ragazze nel Comune di Kurbin.

Sebbene ZVAP/AKPA offrano un'ampia gamma di programmi, corsi professionali, sovvenzioni per iniziative di autoimpiego, tirocini, occupazione con sussidi salariali, programmi stagionali e orientamento professionale, i dati mostrano che una parte consistente della popolazione non è a conoscenza di queste opportunità.

La diffusione delle informazioni rimane molto limitata. Le comunicazioni avvengono principalmente tramite piattaforme online, social network o manifesti affissi fisicamente presso l'Ufficio del Lavoro di Laç. Queste modalità non coprono l'intero territorio del comune e non rispondono alle esigenze di donne e ragazze che vivono in aree rurali come Gorre, Fushë-Kuqe, Milot, Mamurras o in quartieri isolati con infrastrutture carenti.

Per molte di loro, la distanza fisica dalle istituzioni, la mancanza di trasporti e di connessione a internet, o l'assenza di dispositivi digitali, rendono impossibile l'accesso alle informazioni ufficiali.

Azioni coordinate di informazione e sensibilizzazione

Per migliorare l'accesso di donne e ragazze nelle aree rurali alle opportunità di lavoro e formazione professionale, possono essere intraprese una serie di azioni coordinate.

La creazione di una Rete di Informazione “Kurbin Punëson”, basata su WhatsApp/Viber e sulla pagina Facebook del comune, garantirà aggiornamenti regolari su corsi, tirocini e posti di lavoro disponibili.

L'installazione di punti informativi in ciascuna unità amministrativa, come scuole, centri comunitari e uffici comunali, offrirà punti di accesso fisici per tutti i cittadini. Campagne informative sul territorio, tramite incontri comunitari e visite porta a porta alle donne nei villaggi, aumenteranno la consapevolezza delle opportunità esistenti. Comunicazioni personalizzate per le ragazze disoccupate, realizzate in collaborazione con ZVAP e le scuole superiori, mireranno alle esigenze specifiche di questo gruppo, mentre la partnership con organizzazioni non governative faciliterà la diffusione delle informazioni tra le donne più vulnerabili.

Queste azioni integrate creeranno un sistema informativo completo, aumentando l'accesso, la partecipazione e le opportunità di occupazione e formazione professionale.



Thellime mbi Qasja Gjimore


Approfondimenti sull'Approccio di Genere



**Mirëqenia
Sociale**
Cura
Sociale



**Dhuna ndaj Grave
dhe Vajzave**
Violenza contro
Donne e Ragazze



**Fuqizimi
Ekonomik**
Empowerment
economico



Qasja Gjinore në Mirëqenia Sociale

Pabarazitë gjinore në Kurbin prekin në mënyrë veçanërisht të theksuar gratë dhe vajzat, duke thelluar **barrierat ekonomike, sociale dhe kulturore** që kufizojnë qasjen në arsim, punësim dhe pjesëmarrje publike.

Vajzat, sidomos në zonat rurale, përballen me kufizime të buruara nga normat tradicionale, **perceptimet e sigurisë dhe pritshmëritë familjare**, që i mbajnë shpesh brenda shtëpisë dhe u zvogëlojnë mundësinë për të krijuar rrjete sociale, zhvilluar aftësi dhe marrë role lidërshepi.

Mungesa e hapësirave të sigurta dhe e infrastrukturës adekuate, së bashku me mungesën e transportit publik, kufizon qasjen në kurse profesionale, gjuhësore dhe teknologjike, duke i ekspozuar vajzat ndaj izolimit, ngarkesave të hershme të kujdesit dhe martesave të parakohshme. Këta faktorë prodhojnë një **hendek gjinor të qëndrueshëm**: vajzat kanë më pak mundësi për arsim dhe trajnime, më pak qasje në punësim dhe përfaqësim të pakët në jetën publike, duke rrezikuar të trashëgojnë të njëjtat kufizime të brezave të mëparshëm.

Gratë e rritura, veçanërisht ato të moshuara ose me aftësi të kufizuara, janë më të marginalizuara, përfshijnë **izolim social, varfëri, mungesë pronësie** dhe vështirësi në qasje ndaj shërbimeve bazë, me pasoja direkte për dinjitetin dhe autonominë ekonomike. Gratë në familjet me të ardhura të ulëta përballen me **një disavantazh trefish**: pabarazitë ekonomike, barrën e punëve të kujdesit të papaguara dhe mungesën e lëvizjes së pavarur, që kufizon qasjen në arsim, punë dhe pjesëmarrje komunitare.

Kombinimi i roleve tradicionale, mungesës së transportit dhe shërbimeve mbështetëse riprodhon cikle varësie ekonomike, izolimi dhe varfërie, duke prekur në mënyrë të diferencuar edhe **gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara**, të cilat përballen me diskriminim të dyfishtë dhe rrezik më të lartë dhune dhe përjashtimi.

Një qasje gjinore kërkon **shërbime gjithëpërfshirëse, hapësira të sigurta dhe mbështetje specifike** për kujdestaret gra dhe personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të gjithë të mund të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre, të marrin pjesë në jetën publike dhe të zhvillojnë autonomi ekonomike dhe sociale.

Approccio di Genere nella Cura Sociale

Le disuguaglianze di genere a Kurbin colpiscono in modo particolarmente grave donne e ragazze, accentuando le **barriere economiche, sociali e culturali** che limitano accesso all'istruzione, occupazione e partecipazione pubblica.

Le ragazze, soprattutto nelle aree rurali, affrontano restrizioni derivanti da norme tradizionali, **percezioni di sicurezza e aspettative familiari**, che le tengono più spesso in casa e riducono la possibilità di sviluppare reti sociali, competenze e ruoli di leadership.

La **manca di spazi sicuri e infrastrutture adeguate**, insieme all'assenza di trasporti pubblici, limita l'accesso a corsi professionali, linguistici e tecnologici, esponendo le giovani a isolamento, carichi di cura precoci e matrimoni precoci. Questi fattori generano un **divario di genere persistente**: le ragazze hanno meno opportunità di istruzione e formazione, minore accesso al lavoro e scarsa rappresentanza nella vita pubblica, rischiando di ereditare le stesse limitazioni delle generazioni precedenti.

Le **donne adulte**, e in particolare quelle più anziane o con disabilità, sono ulteriormente marginalizzate, vivendo **isolamento sociale, povertà, assenza di proprietà** e difficoltà nell'accesso a servizi essenziali, con conseguenze dirette sulla dignità e autonomia economica. Le donne in famiglie a basso reddito affrontano un **triplice svantaggio**: disparità economiche, carico di lavoro di cura non retribuito e mancanza di mobilità indipendente, che limita l'accesso a istruzione, lavoro e partecipazione comunitaria.

La combinazione di ruoli tradizionali, assenza di trasporti e servizi di supporto perpetua cicli di dipendenza economica, isolamento e povertà, colpendo in maniera differenziata anche **donne e ragazze con disabilità**, che subiscono **discriminazione multipla** e maggiori rischi di violenza e esclusione.

Una prospettiva di genere richiede dunque **servizi inclusivi, spazi sicuri e supporto specifico** per caregiver donne e persone con disabilità, affinché tutte possano esercitare pienamente i propri diritti, partecipare alla vita pubblica e sviluppare autonomia economica e sociale.



Qasja Gjimore në Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave

Mentaliteti patriarkal në Kurbin krijon një strukturë të fuqishme pabarazie gjimore, ku burrat perceptohen si autoriteti kryesor dhe **gratë vendosen në role nënshtruese**, të kufizuara dhe shpesh të pavlerësuara. Ky sistem vlerash ushqen një mjedis ku **dhuna ndaj grave** dhe vajzave nuk vetëm tolerohet, por shpesh konsiderohet e justifikueshme si **pjesë e rendit familjar**.

Gratë që përpiqen të sfidojnë këtë model shoqëror përballen me presion social, stigmatizim, turpërim dhe izolim, duke krijuar një klimë ku denoncimi i dhunës shihet si thyerje e normave të komunitetit. Vajzat e reja rriten në këtë mjedis duke mësuar të mos sfidojnë autoritetin mashkullor, të pranojnë kufizime në lirinë personale dhe të mos kërkojnë të drejtat e tyre, ndërsa mungesa e modeleve femërore të pavarësisë ekonomike i pengon të zhvillojnë aftësi, vetëbesim dhe mundësi për pjesëmarrje aktive në komunitet.

Mungesa e reagimit efektiv të institucioneve e thëllon këtë pabarazi, pasi gratë dhe vajzat mbeten të pambrojtura, humbasin besimin te shteti dhe shpesh përjetojnë viktimizim të dytë përmes paragjyqimeve, pyetjeve akuzuese dhe trajtimit jo-sensibil. Pa mbështetje institucionale, **dhuna riprodhohet ndër breza**, duke krijuar një cikël të vazhdueshëm frike, heshtjeje dhe pasigurie. **Mungesa e strehimit të sigurt** për gratë dhe vajzat, veçanërisht ato pa të ardhura të pavarura, pa rrjete mbështetëse dhe me fëmijë të mitur, i detyron ato të zgjedhin midis dhunës dhe pasigurisë totale, duke i mbërthyer në një mekanizëm kontrolli fizik, psikologjik dhe ekonomik. Kjo gjendje jo vetëm rrezikon sigurinë dhe jetën e tyre, por edhe aftësinë për të marrë vendime dhe për të zhvilluar autonomi.

Vajzat, nga ana tjetër, përjetojnë trauma të thella, ndërpriten nga shkolla dhe rriten në pasiguri, duke mësuar se dhuna është një realitet i pashmangshëm. **Mungesa e strukturave të rehabilitimit dhe mbështetjes psikosociale** e vështirëson rikuperimin emocional dhe ekonomik, duke e shndërruar dhunën në një plagë afatgjatë sociale që prek familjen dhe komunitetin. Ne perfundim për **gratë e moshuara dhe ato me aftësi të kufizuara**, pabarazia dhe rreziku i dhunës janë edhe më të theksuara, për shkak të varfërisë, mungesës së pronësisë, izolimit social dhe pamundësisë për të aksesuar shërbime themelore.

Approccio di Genere nella Violenza contro Donne e Ragazze

La mentalità patriarcale a Kurbin crea una struttura profonda di disuguaglianza di genere, in cui gli uomini sono percepiti come autorità principale e **donne e ragazze sono collocate in ruoli subordinati**, limitati e spesso svalutati. Questo sistema di valori alimenta un ambiente in cui la **violenza contro donne** e ragazze non solo è tollerata, ma spesso considerata giustificabile come **parte dell'ordine familiare**.

Le donne che cercano di sfidare questo modello sociale affrontano pressioni sociali, stigmatizzazione, vergogna e isolamento, creando un clima in cui denunciare la violenza è visto come una violazione delle norme comunitarie. Le ragazze crescono imparando a non sfidare l'autorità maschile, ad accettare restrizioni alla loro libertà personale e a non rivendicare i propri diritti, mentre la mancanza di modelli femminili di indipendenza economica limita le loro capacità, l'autostima e le opportunità di partecipazione attiva nella comunità.

La **mancanza di una risposta efficace** da parte delle istituzioni approfondisce questa disuguaglianza, poiché donne e ragazze rimangono senza protezione, perdono fiducia nello Stato e spesso subiscono una "seconda vittimizzazione" attraverso pregiudizi, domande accusatorie e trattamenti insensibili. Senza supporto istituzionale, **la violenza si riproduce tra le generazioni**, creando un ciclo continuo di paura, silenzio e insicurezza.

La **mancanza di rifugi sicuri** per donne e ragazze, soprattutto per chi non ha redditi propri, reti di supporto o figli minorenni, le costringe a scegliere tra violenza e totale insicurezza, intrappolandole in un meccanismo di controllo fisico, psicologico ed economico. Questa situazione non solo mette a rischio la loro sicurezza e vita, ma limita anche la capacità di prendere decisioni e sviluppare autonomia.

Le ragazze, dal canto loro, subiscono traumi profondi, interrompono la scuola e crescono nell'insicurezza, imparando che la violenza è una realtà inevitabile. La **mancanza di strutture di riabilitazione e supporto psicosociale** rende difficile il recupero emotivo ed economico, trasformando la violenza in una ferita sociale a lungo termine che colpisce famiglie e comunità. Per le **donne anziane** e quelle **con disabilità** infine, la disuguaglianza e il rischio di violenza sono ancora più marcati, a causa della povertà, della mancanza di proprietà, dell'isolamento sociale e dell'impossibilità di accedere ai servizi essenziali.



Qasja Gjinore në Fuqizimi Ekonomik

Kjo problematikë ka një **ndikim të thellë gjinor**, pasi vajzat dhe gratë janë më të ekspozuara ndaj pasojave të mospërputhjes midis arsimit dhe tregut të punës. Ndërsa djemtë kanë më shumë mundësi të hyjnë në profesione teknike, të kërkuara dhe me paga më të larta, vajzat shpesh orientohen drejt drejtimeve që nuk korrespondojnë me sektorët me rritje ekonomike dhe kërkesë të lartë për punë.

Mungesa e lidhjes shkollë–biznes prek dyfish vajzat: ato nuk fitojnë aftësitë që kërkon tregu dhe, njëkohësisht, nuk priten si candidate të barabarta në sektorët teknikë, duke i vendosur në një **pozitë konkurruese të dobët** dhe duke i kufizuar në tregje pune me të ardhura të ulëta, pa kontrata dhe pa mundësi zhvillimi profesional. Pabarazia në formim përkthehet më pas në pabarazi në punë, të ardhura dhe autonomi ekonomike.

Kufizimet strukturore janë edhe më të forta në zonat rurale, ku mungesa e transportit publik i mbyll vajzat dhe gratë brenda shtëpisë dhe u pengon qasjen në kurse trajnimi apo punë jashtë fshatit. Barrë e punëve të kujdesit për fëmijë, të moshuar dhe punë shtëpie, bie kryesisht mbi gratë, duke ua marrë kohën dhe mundësinë për zhvillim profesional.

Stigmatizimi, kontrolli familjar dhe perceptimi i rrezikut e reduktojnë edhe më shumë autonominë e vajzave. **Mungesa e informacionit** për kurse, vende pune apo programe mbështetëse përjashton në mënyrë disproporcionale gratë, sidomos ato pa qasje të qëndrueshme në internet ose rrjete komunitare, duke i penguar të regjistrohen në kurse profesionale dhe të përdorin mundësitë ekonomike ekzistuese.

Si rezultat, vajzat humbasin mundësinë për t'u kualifikuar në profesione të kërkuara dhe të mirëpaguara, duke mbetur të orientuara drejt punëve informale, me paga të ulëta ose jo të mbrojtura, duke e zgjatur **varësinë ekonomike** dhe duke riprodhuar **pabarazitë ndërbreznore** në arsim, aftësi dhe punësim. Ky hendek i padukshëm prodhon pabarazi të thellë: gratë dhe vajzat mbeten jashtë zhvillimit ekonomik jo për mungesë aftësish, por për mungesë dijenie mbi mundësitë ekzistuese, duke intensifikuar izolimin ekonomik, diferencat midis grave urbane dhe rurale dhe kufizuar perspektivën e tyre për pavarësi financiare dhe integrim në tregun e punës.

Approccio di Genere nell'Empowerment economico

Questa problematica ha un **profondo impatto di genere**, poiché ragazze e donne sono maggiormente esposte alle conseguenze della disconnessione tra istruzione e mercato del lavoro. Mentre i ragazzi hanno più opportunità di accedere a professioni tecniche, richieste e meglio remunerate, le ragazze sono spesso orientate verso percorsi che non corrispondono ai settori in crescita economica e con alta domanda di lavoro.

La **mancanza di collegamento scuola–impresa** colpisce le ragazze due volte: non acquisiscono le competenze richieste dal mercato e, contemporaneamente, non vengono considerate candidate pari nei settori tecnici, collocandole in una **posizione competitiva svantaggiata** e limitandole a lavori a basso reddito, senza contratti stabili e con poche opportunità di sviluppo professionale. Questa disparità nell'istruzione si traduce poi in disuguaglianza nel lavoro, nei redditi e nell'autonomia economica.

Le **barriere strutturali** sono ancora più forti nelle aree rurali, dove la mancanza di trasporto pubblico limita la mobilità di donne e ragazze, impedendo loro di partecipare a corsi di formazione o a opportunità lavorative fuori dal villaggio. Il carico dei lavori di cura, per bambini, anziani o per la casa, grava principalmente sulle donne, sottraendo tempo e possibilità di sviluppo professionale.

La **stigmatizzazione**, il **controllo familiare** e la **percezione del rischio** riducono ulteriormente la loro autonomia. La **mancanza di informazioni** su corsi, posti di lavoro o programmi di supporto esclude in modo sproporzionato le donne, soprattutto quelle senza accesso stabile a Internet o a reti comunitarie, impedendo loro di iscriversi a corsi professionali e di sfruttare le opportunità economiche disponibili.

Di conseguenza, le ragazze perdono la possibilità di qualificarsi in professioni richieste e ben remunerate, rimanendo orientate verso lavori informali, a basso salario o non protetti, prolungando la **dipendenza economica** e riproducendo le **disuguaglianze intergenerazionali** nell'istruzione, nelle competenze e nell'occupazione. Questo divario invisibile produce una profonda disuguaglianza: donne e ragazze restano escluse dallo sviluppo economico non per mancanza di competenze, ma per mancanza di consapevolezza delle opportunità esistenti, intensificando l'isolamento economico, le differenze tra donne urbane e rurali e riducendo le loro prospettive di indipendenza finanziaria e integrazione nel mercato del lavoro.

Aktorët Kryesorë dhe Roli i tyre


Gli Attori Principali e il loro Ruolo



**Mirëqenia
Sociale**
Cura
Sociale



**Dhuna ndaj Grave
dhe Vajzave**
Violenza contro
Donne e Ragazze



**Fuqizimi
Ekonomik**
Empowerment
economico



Në Kurbin, gratë dhe vajzat përballen me pabarazi të mëdha gjinore që kufizojnë qasjen e tyre në arsim, formim profesional, punësim dhe pjesëmarrje publike. Vajzat nga zonat rurale përballen me kufizime kulturore, mungesë transporti dhe hapësirash të sigurt, izolim dhe ngarkesa të hershme të kujdesit, të cilat e përsërisin hendekun gjinor. Gratë e rritura, të moshuara ose me aftësi të kufizuara jetojnë në varfëri, përjashtim social dhe me qasje të kufizuara në shërbime, çka ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në autonominë e tyre. Kombinimi i normave tradicionale dhe pabarazitë ekonomike ruajnë ciklet e varësisë.

Bashkia e Kurbin

Bashkia ka një rol qendror në të gjitha fushat. Ajo mund të koordinojë krijimin dhe menaxhimin e strukturave dhe shërbimeve si qendrat rinore, qendrat ditore për të moshuarit, hapësirat e lojës për fëmijët, njësitë për personat me aftësi të kufizuara dhe qendrat informuese për familjet në nevojë. Nëpërmjet drejtorive të saj specifike (Rinia, Shërbimet Sociale, Arsimi, Transporti), mund të planifikojë aktivitete kulturore, sportive dhe formuese, të promovojë pjesëmarrjen qytetare dhe të lehtësojë bashkëpunimin midis institucioneve, OJF-ve dhe bizneseve lokale. Gjithashtu, Bashkia mund të ndërhyjë në rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike, duke garantuar akses dhe siguri për të gjithë.

Zyrat dhe Qendrat e Formimit Profesional (ZVAP/QFP)

Zyrat e formimit profesional mund të mbështesin përfshirjen sociale dhe autonominë ekonomike të të rinjve, grave dhe personave në nevojë. Ato ofrojnë kurse teknike dhe digjitale, praktika profesionale dhe mentorim në bashkëpunim me bizneset lokale, duke zhvilluar aftësi që janë të kërkuara në tregun e punës. Në kontekstin e familjeve me vështirësi ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuara, mund të organizojnë programe pune të mbështetur ose trajnime specifike, duke lehtësuar hyrjen në tregun e punës dhe duke reduktuar rrezikun e përjashtimit social.

Qendrat shëndetësore dhe shërbimet psikosociale

Qendrat shëndetësore dhe profesionistët psikosocialë mbështesin fëmijët, të rinjtë, të moshuarit dhe grupet vulnerabël duke garantuar qasje në shërbime mjekësore, psikologjike dhe terapeutike. Ato mund të organizojnë shërbime lëvizëse për komunitetet rurale, të parandalojnë trauma, të menaxhojnë nevojat psikosociale dhe të promovojnë mirëqenie emocionale e shëndet mendor. Bashkëpunojnë me shkollat dhe OJF-të për të zhvilluar programe mbështetëse afatgjata, me vëmendje të veçantë për gratë.

A Kurbin donne e ragazze affrontano forti disuguaglianze di genere che limitano accesso a istruzione, formazione, lavoro e partecipazione pubblica. Le ragazze rurali subiscono restrizioni culturali, mancanza di trasporti e spazi sicuri, isolamento e carichi di cura precoci, che perpetuano il divario di genere. Le donne adulte, anziane o con disabilità vivono povertà, esclusione sociale e accesso limitato ai servizi, con ripercussioni sulla loro autonomia. La combinazione di norme tradizionali, assenza di supporti e disuguaglianze economiche mantiene cicli di dipendenza e marginalizzazione.

Comune di Kurbin

Il Comune ha un ruolo centrale in tutte le cinque aree tematiche. Può coordinare la creazione e gestione di strutture e servizi, come centri giovanili, centri diurni per anziani, spazi gioco per bambini, unità per persone con disabilità e centri informativi per famiglie vulnerabili. Attraverso le sue direzioni specifiche (Gioventù, Servizi Sociali, Istruzione, Trasporti), può pianificare attività culturali, sportive e formative, promuovere la partecipazione dei cittadini nelle decisioni e facilitare la rete tra istituzioni, ONG e imprese locali. Inoltre, può intervenire nella regolamentazione e nella manutenzione dell'infrastruttura pubblica, garantendo accessibilità e sicurezza.

Uffici e Centri di Formazione Professionale (ZVAP/QFP)

Gli uffici di formazione professionale possono sostenere l'inclusione sociale e l'autonomia economica dei giovani, delle donne e delle persone vulnerabili. Offrono percorsi di apprendimento tecnico e digitale, tirocini e mentoring con le imprese locali, promuovendo competenze spendibili sul mercato del lavoro. Nel contesto delle famiglie con problemi socio-economici e delle persone con disabilità, possono creare programmi di lavoro supportato o corsi specifici, facilitando l'accesso a opportunità professionali e riducendo il rischio di esclusione sociale.

Centri sanitari e servizi psicosociali

I centri sanitari e gli operatori psicosociali supportano bambini, giovani, anziani e persone vulnerabili garantendo accesso a servizi medici, psicologici e terapeutici. Possono organizzare interventi mobili per comunità rurali, prevenire traumi, gestire bisogni psicosociali, favorire il benessere emotivo e promuovere la salute mentale. Collaborano con scuole e ONG per creare programmi di supporto continuativo, con attenzione speciale alle donne e alle ragazze più vulnerabili.



OJF-të dhe Organizatat Partnere

OJF-të mund të veprojnë si partnerë operativë dhe avokues në të gjitha fushat tematike. Ato mund të menaxhojnë shërbime specifike (qendra për fëmijë, të rinj, të moshuar apo persona me aftësi të kufizuara), të ofrojnë mbështetje psikosociale, trajnime dhe mentorim, të organizojnë fushata ndërgjegjëse për çështjet gjinore dhe të nxisin pjesëmarrjen komunitare. OJF-të kanë rol kyç në integrimin e dimensionit gjinor, fuqizimin e vajzave dhe grave, si dhe në mbështetjen e familjeve në nevojë. Ato mund të lidhin qytetarët me shërbimet publike dhe të monitorojnë efektivitetin e ndërhyrjeve.

Shkollat (9-vjeçare dhe të mesme)

Shkollat luajnë një rol thelbësor në zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve. Ato mund të ofrojnë aktivitete jashtëshkollore, punëtori krijuese, sportive dhe teknologjike, si dhe mbështetje psikosociale nëpërmjet psikologëve shkollorë. Shkollat mund të ndërgjegjësojnë nxënësit dhe familjet mbi barazinë gjinore, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të vajzave dhe duke reduktuar stereotipet. Gjithashtu, ato shërbejnë si pika referimi për projekte përfshirëse për fëmijët me nevoja të veçanta ose nga familje në situata të vështira.

Njësitë Administrative

Në zonat rurale më të izoluar, njësitë administrative përfaqësojnë të vetmin institucion pranë qytetarëve. Nëse trajnohen dhe pajisen me mjete operacionale, punonjësit e tyre mund të identifikojnë në kohë rastet e dhunës në familje, përjashtimit shëndetësor ose diskriminimit gjinor, duke vepruar si ndërmjetës socialë realë. Me mbështetjen formuese të bashkisë dhe OJF-ve, këto njësi mund të shndërrohen në platforma të mobilizimit komunitar, duke nxitur diskutime publike mbi dhuna ndaj grave, të drejtat e grave dhe barazinë në qasje ndaj shërbimeve.

ONG e Organizazioni Partner

Le ONG possono intervenire come partner operativi e di advocacy in tutte le aree tematiche. Possono gestire servizi specifici (centri per bambini, giovani, anziani o persone con disabilità), fornire supporto psicosociale, formazione e mentoring, organizzare campagne di sensibilizzazione sulle questioni di genere e facilitare la partecipazione comunitaria. Le ONG hanno un ruolo chiave nell'integrazione delle dimensioni di genere, nell'empowerment delle ragazze e delle donne e nel sostegno alle famiglie vulnerabili. Possono anche collegare i cittadini ai servizi pubblici, monitorando l'efficacia degli interventi.

Scuole (9-vjeçare e secondarie)

Le scuole possono svolgere un ruolo fondamentale nello sviluppo dei bambini e dei giovani. Possono ospitare attività extracurricolari, laboratori creativi, sportivi e tecnologici, nonché offrire supporto psicosociale attraverso la presenza di psicologi. Le scuole possono anche sensibilizzare studenti e famiglie sulle disuguaglianze di genere, promuovendo la partecipazione attiva delle ragazze e la riduzione degli stereotipi. Inoltre, fungono da punto di riferimento per progetti di inclusione per bambini con bisogni speciali o in contesti vulnerabili.

Unità Amministrative

Nei territori rurali più isolati, le unità amministrative rappresentano l'unico presidio istituzionale vicino ai cittadini. Se adeguatamente formati e dotati di strumenti operativi, i loro funzionari possono individuare tempestivamente casi di violenza domestica, esclusione sanitaria o discriminazione di genere, agendo come veri mediatori sociali. Con il supporto formativo della municipalità e delle ONG, queste unità possono trasformarsi in piattaforme di mobilitazione comunitaria, favorendo discussioni pubbliche sulla violenza di genere, i diritti delle donne e la parità di accesso ai servizi.



Në Kurbin, mentaliteti patriarkal ruan pabarazi të forta: burrat konsiderohen autoritet, ndërsa gratë dhe vajzat mbeten të nënshtruara dhe të cënueshme ndaj dhunës, shpesh e toleruar socialisht. Mungesa e strehimeve, mbështetjes institucionale dhe modeleve femërore të pavarura i kapërcen ato në cikle frike dhe varësie, duke goditur në mënyrë edhe më të rëndë gratë e moshuara dhe ato me aftësi të kufizuara.

Bashkia Kurbin

Bashkia luan një rol qendror në drejtimin e reagimit kundër dhunës me bazë gjinore. Ajo duhet të udhëheqë fushatat e ndërgjegjësimit për ndryshimin e mentalitetit patriarkal, duke përfshirë shkollat, komunitetet dhe mediat lokale. Në të njëjtën kohë, ka përgjegjësi për të forcuar koordinimin institucional përmes Mekanizmit të Referimit, duke siguruar që çdo rast të trajtohet shpejt e në mënyrë të integruar. Bashkia duhet gjithashtu të sigurojë fonde për hapjen e një qendre ditore dhe strehimi emergjent, si dhe për mbështetje psikosociale dhe riintegrim ekonomik të grave.

Policia e Shtetit

Policia është hallka e parë e reagimit ndaj dhunës. Ajo duhet të garantojë mbrojtje të menjëhershme, respektimin e urdhrave të mbrojtjes dhe ndjeshmëri gjinore në trajtimin e viktimave. Trajnimet mbi komunikimin pa paragjykim dhe protokollat e konfidencialitetit janë thelbësore për të shmangur viktimizimin e dytë. Policia mund të bashkëpunojë ngushtë me bashkinë dhe OJF-të për të siguruar referim të sigurt dhe për të ndihmuar në zbatimin e fushatave kundër dhunës dhe ndryshimit të kulturës patriarkale.

Shkollat dhe ZVAP

Institucionet arsimore kanë një rol thelbësor në ndryshimin e mentalitetit patriarkal dhe në edukimin e brezave të rinj për marrëdhënie të shëndetshme dhe respekt të ndërsjellë. Përmes edukimit gjinor, klubeve rinore dhe bashkëpunimit me prindërit, shkollat mund të ndikojnë në uljen e tolerancës ndaj dhunës. Ato duhet gjithashtu të identifikojnë vajzat në rrezik dhe të bashkëpunojnë me mekanizmat lokalë të mbrojtjes. Në këtë mënyrë, arsimi bëhet një faktor parandalues i fuqishëm kundër riprodhimit të pabarazive ndër breza.

A Kurbin la mentalità patriarcale mantiene forti disuguaglianze: gli uomini sono considerati autorità, mentre donne e ragazze restano subordinate e vulnerabili alla violenza, spesso tollerata socialmente. La mancanza di rifugi, sostegno istituzionale e modelli femminili indipendenti le intrappola in cicli di paura e dipendenza, colpendo in modo ancora più grave anziane e donne con disabilità.

Comune di Kurbin

Il Comune ha un ruolo centrale nella risposta alla violenza di genere. Deve guidare le campagne di sensibilizzazione per cambiare il mentalità patriarcale, coinvolgendo scuole, comunità e media locali. Al tempo stesso, è responsabile del rafforzamento del coordinamento istituzionale attraverso il Meccanismo di Riferimento, garantendo che ogni caso venga gestito in modo rapido e integrato. Il Comune deve anche prevedere fondi per l'apertura di un centro diurno e di un alloggio di emergenza, oltre a sostenere il reinserimento psicossociale ed economico delle donne.

Polizia di Stato

La polizia rappresenta il primo livello di risposta nei casi di violenza. Deve assicurare protezione immediata, applicazione delle ordinanze di protezione e sensibilità di genere nel trattamento delle vittime. La formazione su comunicazione non giudicante e riservatezza è essenziale per evitare la vittimizzazione secondaria. La Polizia può collaborare strettamente con il Comune e le ONG per garantire un rinvio sicuro dei casi e partecipare a campagne di prevenzione e cambiamento culturale.

Scuole e Direzione Locale dell'Istruzione (ZVAP)

Le istituzioni educative hanno un ruolo cruciale nel trasformare la mentalità patriarcale e nel promuovere relazioni sane e paritarie tra i giovani. Attraverso l'educazione di genere, i club giovanili e la collaborazione con i genitori, le scuole possono ridurre la tolleranza verso la violenza. Devono inoltre identificare le ragazze a rischio e collaborare con i meccanismi locali di protezione. L'educazione diventa così un fattore decisivo per prevenire la riproduzione delle disuguaglianze di genere tra generazioni.



OJF-të e specializuara

Organizatrat e grave dhe ato që merren me mbrojtjen sociale janë partnerë thelbësorë për mbështetje psikologjike, juridike dhe ekonomike të viktimave. Ato mund të menaxhojnë qendra strehimi, të ofrojnë shërbime të linjave të ndihmës dhe të ndërmjetësojnë me institucionet publike. OJF-të luajnë një rol të pazëvendësueshëm në ngritjen e zërit të grave, monitorimin e zbatimit të ligjit dhe edukimin publik për barazinë gjinore. Përmes tyre, besimi i grave tek sistemi rritet dhe raportimi bëhet më i sigurt.

Komunitetet fetare dhe media lokale

Këta aktorë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në formësimin e normave kulturore. Predikimet fetare, programet radio-televizive lokale dhe rrjetet sociale mund të përdoren për të sfiduar mesazhet patriarkale dhe për të promovuar respektin dhe dinjitetin e grave. Angazhimi i tyre është vendimtar për të prishur heshtjen dhe për të ndryshuar perceptimin e dhunës si “çështje familjare”. Kur komunitetet fetare dhe media flasin me një zë të qartë kundër dhunës, ato krijojnë kushte reale për ndryshim social dhe për mbështetje komunitare ndaj viktimave.

Organizzazioni della società civile (ONG)

Le ONG specializzate svolgono un ruolo fondamentale nel fornire supporto psicologico, legale ed economico alle vittime. Possono gestire centri di accoglienza, offrire servizi di emergenza e mediare tra istituzioni pubbliche e donne. Sono anche attori chiave nel monitoraggio delle politiche, nella sensibilizzazione pubblica e nel rafforzamento del ruolo delle donne nella comunità. Il loro lavoro contribuisce a creare fiducia nel sistema e ad aumentare la propensione delle donne a denunciare la violenza.

Comunità religiose e media locali

Questi attori influenzano direttamente i valori sociali e culturali. Sermoni, programmi radio-televisivi e contenuti sui social media possono essere strumenti efficaci per contrastare messaggi patriarcali e promuovere il rispetto e la dignità delle donne. Il loro impegno è decisivo per rompere il silenzio, superare la stigmatizzazione e cambiare la percezione della violenza come “problema familiare”. Quando comunità religiose e media parlano con una voce unitaria contro la violenza, favoriscono un autentico cambiamento culturale e sostegno sociale alle vittime.



Në Kurbin, shkëputja midis arsimit dhe tregut të punës prek veçanërisht gratë dhe vajzat, të cilat kanë më pak mundësi për të ndjekur drejtime teknike dhe profesione të paguara mirë. Mungesa e lidhjes shkollë-ndërmarrje, e kombinuar me lëvizshmëri të kufizuar, ngarkesë kujdesi dhe mungesë informacioni, i përjashton ato nga mundësitë arsimore dhe punësimi që po zhvillohen. Në zonat rurale, këto pengesa thellohen edhe më shumë, duke forcuar varësinë ekonomike dhe duke riprodhuar pabarazitë ndërbreznore në arsim, punësim dhe autonomi financiare.

Bashkia Kurbin

Bashkia ka rol udhëheqës në koordinimin e politikave lokale për arsim, punësim dhe zhvillim ekonomik. Ajo duhet të udhëheqë hartimin e një harte të kërkesës për aftësi (skills mapping), të përditësojë kurrikulat profesionale në bashkëpunim me ZVAP dhe QFP, dhe të sigurojë kushte logjistike si transport publik rural dhe hapësira për qendrat e trajnimit. Bashkia është gjithashtu përgjegjëse për krijimin e një rrjeti informacioni gjithëpërfshirës mbi kurset, subvencionet dhe mundësitë e punësimit, në mënyrë që asnjë vajzë apo grua të mos mbetet pa informacion.

ZVAP dhe Shkollat Profesionale

ZVAP dhe shkollat profesionale janë përgjegjëse për përafrimin e ofertës arsimore me nevojat e tregut lokal të punës. Duhet të krijojnë partneritete me bizneset, të ofrojnë praktikë reale në kompani, dhe të promovojnë orientim karriere me qasje gjinore. Një tjetër detyrë është sigurimi i aksesit të vajzave në profile teknike përmes bursave, mentorimit dhe laboratorëve praktikë. Këto institucione luajnë rol kyç në ndryshimin e stereotipeve gjinore në arsimin profesional.

Zyra Vendore e Punësimit / AKPA

Zyra e Punës duhet të sigurojë shpërndarje të barabartë të informacionit mbi programet e punësimit, subvencionet dhe trajnimet, veçanërisht në zonat rurale. Duhet të krijojë kanale komunikimi të aksesueshme (p.sh. rrjete WhatsApp, faqe të bashkisë, kënde informacioni në çdo njësi administrative). Përmes bashkëpunimit me Bashkinë dhe OJF-të, mund të arrijë grupet më të përjashtuara, gratë pa internet, pa transport ose me detyrime familjare. Transparenca dhe proaktiviteti i Zyrës së Punës janë thelbësorë për përfshirjen ekonomike të grave.

A Kurbin, la disconnessione tra istruzione e mercato del lavoro colpisce in modo particolare donne e ragazze, che hanno meno accesso a percorsi tecnici e professioni ben retribuite. La mancanza di collegamento scuola-impresa, unita a mobilità limitata, carichi di cura e scarsa informazione, le esclude dalle opportunità formative e lavorative emergenti. Nelle aree rurali, queste barriere si amplificano, consolidando la dipendenza economica e riproducendo disuguaglianze intergenerazionali nell'istruzione, nell'occupazione e nell'autonomia finanziaria.

Municipalità di Kurbin

Il Comune ha un ruolo guida nel coordinamento delle politiche locali per l'istruzione, l'occupazione e lo sviluppo economico. Deve guidare l'elaborazione di una mappatura delle competenze (skills mapping), aggiornare i curricula professionali in collaborazione con ZVAP e QFP e garantire condizioni logistiche come trasporti pubblici rurali e spazi per i centri di formazione. Il Comune è inoltre responsabile della creazione di una rete informativa completa su corsi, sussidi e opportunità di lavoro, affinché nessuna ragazza o donna rimanga priva di informazioni.

ZVAP e le Scuole Professionali

ZVAP e le scuole professionali sono responsabili dell'allineamento dell'offerta formativa alle esigenze del mercato del lavoro locale. Devono creare partenariati con le imprese, offrire tirocini reali presso le aziende e promuovere l'orientamento professionale con approccio di genere. Un altro compito è garantire l'accesso delle ragazze ai profili tecnici tramite borse di studio, mentoring e laboratori pratici. Queste istituzioni svolgono un ruolo chiave nel cambiare gli stereotipi di genere nell'istruzione professionale.

Ufficio Locale per l'Impiego / AKPA

L'Ufficio per l'Impiego deve garantire una distribuzione equa delle informazioni sui programmi di occupazione, sui sussidi e sulle formazioni, soprattutto nelle aree rurali. Deve creare canali di comunicazione accessibili (ad esempio reti WhatsApp, pagine del comune, punti informativi in ogni unità amministrativa). Attraverso la collaborazione con il Comune e le ONG, può raggiungere i gruppi più esclusi, donne senza accesso a Internet, senza mezzi di trasporto o con responsabilità familiari. Trasparenza e proattività dell'Ufficio sono essenziali per l'inclusione economica delle donne.



Qendrat e Formimit Profesional (QFP)

QFP-të duhet të zhvillojnë oferta fleksibël trajnimi që reflektojnë realisht kërkesën e tregut, si agroturizëm, bujqësi e mekanizuar, shërbime, ndërtim apo teknologji informacioni. Përveç qendrave ekzistuese, duhen krijuar njësi satelitore në çdo njësi administrative dhe trajnime “mobile” në fshatra, që të mund të ndjekin edhe vajzat me kufizime lëvizjeje. QFP-të duhet të bashkëpunojnë me Bashkinë dhe bizneset për të garantuar punësim pas trajnimit dhe për të mbështetur gratë me shërbime kujdesi dhe transport të subvencionuar.

Bizneset Lokale dhe Dhoma e Biznesit

Bizneset kanë rol vendimtar në përafrimin e arsimit profesional me nevojat reale të tregut. Ato duhet të përfshihen në hartimin e kurrikulave, të ofrojnë praktikë, mentorim dhe mundësi punësimi për të rinjtë, veçanërisht për vajzat. Dhoma e Biznesit mund të ndërmjetësojë bashkëpunimin mes shkollave dhe ndërmarrjeve, si dhe të promovojë modelet e suksesit të grave në sektorët teknikë dhe të prodhimit. Pjesëmarrja e tyre ndihmon në krijimin e një tregu pune më gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Centri di Formazione Professionale (QFP)

I QFP devono sviluppare offerte formative flessibili che rispecchino realmente la domanda del mercato, come agroturismo, agricoltura meccanizzata, servizi, costruzioni o tecnologie dell'informazione. Oltre ai centri esistenti, vanno create unità satellitari in ogni unità amministrativa e percorsi formativi “mobili” nei villaggi, in modo da permettere anche alle ragazze con limitazioni di mobilità di partecipare. I QFP devono collaborare con il Comune e le imprese per garantire l'occupazione post-formazione e supportare le donne con servizi di cura e trasporto sovvenzionati.

Imprese Locali e Camera di Commercio

Le imprese giocano un ruolo fondamentale nell'allineare la formazione professionale alle reali esigenze del mercato. Devono partecipare alla definizione dei curricula, offrire tirocini, mentoring e opportunità di lavoro per i giovani, in particolare per le ragazze. La Camera di Commercio può mediare la collaborazione tra scuole e imprese e promuovere modelli di successo femminili nei settori tecnici e produttivi. La loro partecipazione contribuisce a creare un mercato del lavoro più inclusivo e sostenibile.

VEPRIM PILOT

Krijimi i një biblioteke publike në Milot

Në përfundim të procesit të takimeve dhe konsultimeve komunitare, grupi i grave pjesëmarrëse ka identifikuar si prioritet krijimin e **një biblioteke komunitare në Milot**, një investim me ndikim të menjëhershëm dhe afatgjatë në zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik të komunitetit. Ato theksuan se një **hapësirë e tillë nuk ekziston** aktualisht në zonë dhe se nevoja për një ambient të sigurt, edukativ dhe gjithëpërfshirës është shumë e madhe.

Njësia Administrative e Milotit ka vënë tashmë **në dispozicion një ambient** brenda godinës së saj, aktualisht në fazë rikonstruksioni, duke krijuar bazën infrastrukturore të nevojshme për ta transformuar atë në një hapësirë të dedikuar vajzave, grave dhe komunitetit në tërësi.

Biblioteka do të pajiset me **një fond të gjerë librash**, nga literatura bazë për fëmijët e shkollës fillore deri te libra profesionalë, romane bashkëkohore, materiale kërkimore dhe tekste udhëzuese për zhvillimin personal dhe profesional. Për të pasuruar më tej bibliotekën dhe për të forcuar ndjenjën e pronësisë komunitare, do të hapet një thirrje publike për dhurimin e librave, mjeteve didaktike, lodrave edukative dhe materialeve të tjera mësimore.

Biblioteka do të ketë **funksione të shumëfishta**:

- **Për gratë dhe vajzat**: një ambient i qetë dhe mbështetës, ku mund të lexojnë, të marrin pjesë në klube libri, takime informuese, aktivitete zhvillimore dhe kurse të vogla trajnimi, si dhe të ndajnë përvoja jetësore, edhe negative, në **një perspektivë ndihme reciproke**.
- **Për të rinjtë**: një vend studimi, përgatitjeje për provime, realizim projektesh, lexim dhe zhvillim aftësish akademike dhe teknologjike.
- **Për fëmijët**: një hapësirë e sigurt, pranë shkollës, që nxit leximin dhe krijimtarinë.
- **Për komunitetin në tërësi**: një qendër kulturore për aktivitete lokale, diskutime, prezantime dhe iniciativa edukative që forcojnë lidhjet shoqërore dhe kulturën e dijes.

Në një zonë ku mungojnë hapësirat publike të dedikuara zhvillimit intelektual dhe krijues, Biblioteka synon të jetë një ndër ndërhyrjet më të rëndësishme komunitare për të reduktuar hendekun gjinor dhe për të rritur pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në aktivitetet sociale.

AZIONE PILOTA

Creazione di una biblioteca pubblica a Milot

Al termine del processo di incontri e consultazioni comunitarie, il gruppo di donne partecipanti ha identificato come priorità la creazione di una **biblioteca comunitaria a Milot**, un investimento con un impatto immediato e duraturo sullo sviluppo sociale, culturale ed economico della comunità. Hanno sottolineato che **uno spazio simile non esiste** attualmente nella zona e che la necessità di un ambiente sicuro, educativo e inclusivo è molto forte.

L'Unità Amministrativa di Milot ha già messo **a disposizione un locale** all'interno della propria sede, oggi in fase di ristrutturazione, creando la base infrastrutturale necessaria per trasformarlo in uno spazio dedicato alle ragazze, alle donne e all'intera comunità.

La biblioteca sarà dotata di un ampio **patrimonio librario**, dalla letteratura di base per bambini della scuola primaria a libri professionali, romanzi contemporanei, materiali di ricerca e testi orientativi per lo sviluppo personale e professionale. Per arricchire ulteriormente la biblioteca e rafforzare il senso di appartenenza della comunità, sarà lanciata una chiamata pubblica per la donazione di libri, strumenti didattici, giochi educativi e altri materiali di apprendimento.

La biblioteca avrà **funzioni multiple**:

- **Per donne e ragazze**: un ambiente tranquillo e di supporto, dove leggere, partecipare a club del libro, incontri informativi, attività di sviluppo e piccoli corsi di formazione e condivisione di esperienze di vita, anche negative, in un'ottica di **aiuto reciproco**.
- **Per i giovani**: un luogo di studio, preparazione agli esami, realizzazione di progetti, lettura e sviluppo di competenze accademiche e tecnologiche.
- **Per i bambini**: uno spazio sicuro, vicino alla scuola, che incentiva la lettura e la creatività
- **Per la comunità nel suo insieme**: un centro culturale per attività locali, discussioni, presentazioni e iniziative educative che rafforzano i legami sociali e la cultura della conoscenza.

In un'area in cui mancano spazi pubblici dedicati allo sviluppo intellettuale e creativo, la Biblioteca si propone come uno degli interventi comunitari più significativi per colmare il divario di genere, e aumentare la partecipazione di ragazze e donne alle attività sociali.

Axenda e Grave Rurale



Agenda delle Donne Rurali